



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËSIT DHE PROFESIONISTËT E ARSIMIT PËR ROLIN E SHKOLLËS NË PARANDALIMIN DHE IDENTIFIKIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
Hyrje	6
Grupi punues për hartimin e Udhëzuesit	6
Rreth Konventës së Stambollit dhe nenit 14	7

MODULI 1: Të kuptuarit e barazisë gjinore8

Konceptet kryesore.....	8
Gjinia dhe seksi	8
Orientimi seksual dhe identiteti gjinor	8
Barazia gjinore	9
Gender equity (në anglisht)	9
Stereotipat gjinorë	10
Diskriminimi i ndërlidhur.....	11

MODULI 2: Të kuptuarit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.....12

Dhuna ndaj grave (DhNG)	12
Dhuna në familje (DhF)	13
Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) ndaj grave.....	14
Format e dhunës	15
Dhuna psikologjike (neni 33).....	15
Përndjekja (neni 34)	16
Dhuna fizike (neni 35).....	17
Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin (neni 36)	17
Martesa e detyruar (neni 37)	18
Gjymtimi i organeve gjenitale femërore (neni 38).....	18
Ngacmimi dhe ngacmimi seksual (neni 40).....	18
Dhuna e kryer në emër të të ashtuquajturit nder (neni 42).....	19
Dhuna në internet dhe ajo e lehtësuar nga teknologjia.....	20

MODULI 3: Qasja e arsimit gjithëpërfshirës	21
Burimet dhe materialet mësimore	21
Edukimi seksual gjithëpërfshirës (ESGj)	22
Pjesëmarrja, angazhimi i komunitetit dhe puna me zyrat lokale.....	22
 MODULI 4: Informacion për të mbështetur planet mësimore	24
Promovimi i barazisë dhe roleve gjinore jostereotipe	24
Nxitja e të menduarit kritik	25
Aktivitete në klasë dhe diskutime	26
Promovimi i respektit dhe zgjidhjes së konflikteve pa dhunë.....	32
Adresimi i dhunës ndaj grave dhe i dhunës në familje në klasë.....	35
 MODULI 5: Zbulimi i informacioneve për identifikimin dhe reagimin.....	38
Njohja e shenjave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje	38
Qasja në mbështetje.....	38
Sistemet dhe burimet mbështetëse për nxënësit e prekur.....	39
Sistemet dhe burimet mbështetëse për të rriturit e prekur.....	40
Rolet dhe përgjegjësitë	40
Roli i administratës së shkollës	41
Roli i udhëheqjes për mbrojtje/ruajtje të fëmijëve	41
I tërë stafi: Konfidencialiteti dhe ndjeshmëria në trajtimin e informatave të zbuluara	42
Bashkëpunimi me prindërit, kujdestarët dhe shërbimet e jashtme mbështetëse	42
Veprimet e menjëhershme në rast të zbulimit të informatave	42
Bibliografia.....	45

Lista e shkurtesave

■	ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
■	KiE	Këshilli i Evropës
■	ESGj	Edukimi Seksual Gjithëpërfshirës
■	DhF	Dhuna në Familje
■	Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
■	RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
■	LBT/LGBTI	Një term ombrellë i përdorur për të përfshirë gratë lesbike, biseksuale dhe transgjinore/Lesbique, Homoseksualë, Biseksualë, Transgjinorë, Interseks
■	GjOGjF	Gjymtimi i organeve gjenitale femërore
■	DhBGj	Dhuna me Bazë Gjinore
■	GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
■	MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
■	IJK	Imazhi Intim Jokonsensual
■	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
■	PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
■	DhNG	Dhuna ndaj Grave
■	OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
■	UNCRPD	Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
■	UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

Hyrje

Udhëzuesi për mësimdhënës dhe profesionistët e arsimit për rolin e shkollës në parandalimin dhe identifikimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (tutje Udhëzuesi) është hartuar për të ndihmuar mësimdhënësit, edukatorët dhe stafin e shkollave që ta kuptojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, si dhe të reagojnë ndaj tyre në mjediset arsimore, në përputhje me detyrimet e nenit 14 të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe dhunës në Familje (në tekstin e mëtejme ‘Konventa e Stambollit’).

Objektivat e Udhëzuesit janë:

1. të shtojë vetëdijesimin dhe të kuptuarit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
2. të promovojë barazinë gjinore dhe t’i sfidojë rolet gjinore stereotipe
3. të ofrojë mjete dhe udhëzime praktike për mësimdhënësit, stafin mbështetës dhe administrativ, që t’i njohin shenjat e dhunës dhe të dinë si të reagojnë në mënyrë efektive.

Udhëzuesi bazohet në parimet e Konventës së Stambollit dhe në rekomandimet e Grupit të Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO).¹ Ai e shpjegon Konventën e Stambollit dhe nenet e saj përkatëse veç e veç, përmes një qasjeje praktike dhe analitike, të ilustruar me shembuj konkretë, të cilët ndërlidhen me çështjet që Konventa i trajton. Këta shembuj, të paraqitur në dy modulet e para, kanë karakter orientues dhe shpjegues për vetë mësimdhënësit, por nuk synohen për përdorim të drejtpërdrejtë me nxënësit. Në modulet tre dhe katër jepen udhëzime se si mësimdhënësit mund t’i zbatojnë parimet e Konventës së Stambollit në procesin arsimor përmes promovimit të barazisë gjinore dhe respektimit të dinjitetit të njeriut, duke ndikuar pozitivisht në formimin e brezave të rinj.

Grupi punues për hartimin e Udhëzuesit

Grupi punues për hartimin e Udhëzuesit për mësimdhënësit dhe personelin arsimor për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje është themeluar më 11.03.2024 me vendim të Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës (MASHTI). Ky Udhëzues është rezultat i tri takimeve dhe diskutimeve kolegjiale të mbajtura midis qershorit dhe dhjetorit të vitit 2024.

Në bazë të vendimit të Ministres, anëtarët e grupit punues ishin:

- Azize Sekiraqa-Heta, Zyrtare e lartë për Barazi Gjinore, MASHTI - Kryesuese
- Merita Jonuzi, Koordinatore për të Drejtat e Njeriut, MASHTI - Anëtare
- Shqipe Gashi, Zyrtare e Lartë për Kurrikula dhe Tekste, MASHTI - Anëtare
- Florentina Beqiraj, Zyrtare për Barazinë e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë - Anëtare
- Nexhmedin Sejdiu, Drejtor, Shkolla e Mesme “Pjetër Bogdani” Prishtinë – Anëtar
- Betim Sherifi, Mësimdhënës, Shkolla e Mesme “Elena Gjika” Prishtinë – Anëtar
- Adelina Berisha, Menaxhere e Programit, Rrjeti i Grave të Kosovës – Anëtare

¹ GREVIO - Grup i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, organ i pavarur, përgjegjës për monitorimin e zbatimit nga palët e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ([Konventa e Stambollit](#)).

Ky Udhëzues është hartuar nga konsulentja vendore e Këshillit të Evropës, Luljeta Plakolli-Kasumi dhe konsulentja ndërkombëtare e Këshillit të Evropës, Eleri Butler. Dokumenti u hartua me mbështetjen financiare të projektit “**Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit (2023-2026)**”, i zbatuar nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin zyrtar të asnjërës palë.

Rreth Konventës së Stambollit dhe nenit 14

Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës, e miratuar në vitin 2011 dhe e inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës në vitin 2020 (Këshilli i Evropës, 2020), është një kornizë ndërkombëtare që siguron të drejtat e grave për të jetuar pa dhunë, duke u fokusuar në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe politikat e bashkërenduara. Në vitin 2022, respektimin e këtyre standardeve nga Kosova, Këshilli i Evropës e vlerësoi sipas metodologjisë së GREVIO-s (Këshilli i Evropës, 2022).

Konventa e Stambollit e përkufizon **dhunën ndaj grave** si të gjitha format e dhunës me bazë gjinore që shkaktojnë dëme fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, duke përfshirë kërcënimet, detyrimin ose heqjen e lirisë, qoftë në ambiente publike ose private (neni 3(a)). **Dhuna në familje**, që prek të dyja gjinitë, por prek gratë në mënyrë joproporcionale (Këshilli i Evropës, pa datë, Konventa Shkurtime), përfshin dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike brenda një mjedisi familjar ose në familje, ose midis partnerëve të mëparshëm a aktualë, pavarësisht nga lidhjet ligjore ose biologjike (neni 3(b)).

Termi **gjini** u referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhetributeve të ndërtuara shoqërisht që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat (neni 3(c)).² “**Dhuna me bazë gjinore ndaj grave**” i referohet dhunës që ushtrohet ndaj një gruaje sepse është grua, ose që prek gratë në mënyrë joproporcionale (neni 3(d)).³ Neni 14 i Konventës së Stambollit thekson edukimin si mjet për parandalimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore. Për zbatimin efektiv të nenit 14, rekomandohet që shkollat në Kosovë të integrojnë materialet mësimore për barazinë ndërmjet grave dhe burrave, rolet jostereotipe gjinore, respektin, zgjidhjen pa dhunë të mosmarrëveshjeve dhe të drejtën për integritet personal, në të gjitha nivelet e arsimit.⁴ Kjo nënkupton:

- Trajnimin e mësimeve për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës.
- Kultivimin e një kulture të barazisë gjinore dhe të mosdhunës.
- Angazhimin e komunitetit më të gjerë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës (Këshilli i Evropës, 2022, 35).

Përfshirja e parimeve bazë si barazia, mosdiskriminimi dhe mbrojtja nga cenueshmeria, i bën shkollat mbështetëse në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe promovuese të barazisë gjinore në përputhje me Konventën e Stambollit.

² Kjo është në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (neni 3, parag. 1.7) dhe Ligjin për Barazi Gjinore (neni 3, parag. 1.8) në Kosovë në të cilën “gjinia” cilësohet si “rolet e ndërtuara shoqërore të caktuara për gratë dhe burrat, që është një identitet i fituar që mësohet, ndryshohet me kalimin e kohës dhe ndryshon gjerësisht brenda dhe midis kulturave”.

³ Ligji i Kosovës për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore përmban përkufizimin identik. Neni 3, parag. 1.4 përcakton po ashtu se “Dhuna me bazë gjinore ndaj grave i përfshin shkaqet dhe rezultatit e marrëdhënies së pabarabartë të forcës ndërmjet grave dhe meshkujve si rezultat i një problemi social e jo individual”.

⁴ Kjo është përcaktuar në nenin 17 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga DhF, DhNG dhe DhBGj.

MODULI 1:

Të kuptuarit e barazisë gjinore

Konceptet kryesore

Ky Modul ofron shembuj praktikë të koncepteve thelbësore për ta kuptuar dhe avancuar barazinë gjinore. Përmbajtja e këtij Moduli është e vlefshme për të gjithë personelin e shkollës, por duhet pasur parasysh se jo të gjithë shembujt janë të përshtatshëm për t'u përdorë drejtpërdrejt në mësimdhënie me fëmijët, për shkak të ndjeshmërisë së temave që trajtohen. Siç është theksuar edhe në hyrje të materialit, këta shembuj shërbejnë për të ndihmuar mësimdhënësit dhe stafin në të kuptuarit e situatave të dhunës, si dhe për të zhvilluar aftësitë për reagim në mënyrë të duhur përmes trajtimit të rasteve, raportimit dhe referimit të tyre tek autoritetet përkatëse.

Gjinia dhe seksi

Përkufizimi i Konventës së Stambollit për **'gjininë'** (më lart) e dallon këtë nga **gjinia biologjike**⁵, e cila përcaktohet me karakteristika fizike (Këshilli i Evropës, 2016, Fjalorthi për Barazinë Gjinore, 25). Shoqëri të ndryshme kanë ide specifike për tiparet 'maskullore' ose 'femërore', duke e lidhur shpesh maskuliniteti me dominimin dhe kontrollin, ndërsa feminitetin me nënshtrimin (Greig, 2016, 49). Këto role përforcojnë dinamikën e pushtetit që mund t'i dëmtojnë gratë dhe vajzat. Mësimdhënësit dhe personeli arsimor duhet t'i kuptojnë këto dinamika për të sfiduar normat e dëmshme në mënyrë efektive brenda shkollave.

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor

'Orientimi seksual' përshkruan se ndaj kujt tërhiqet personi në mënyrë romantike ose seksuale, ndërsa **'identiteti gjinor'**⁶ i referohet ndjenjës së brendshme të individit për gjininë, e cila mund të mos përputhet me seksin e vet biologjik (Moleiro & Pinto, 2015). Orientimi seksual i individit është i pavarur nga identiteti i vet gjinor (Human Rights Campaign, pa datë). Neni 4(3) i Konventës së Stambollit ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke marrë parasysh faktorët e ndjeshmërisë së individëve që janë lesbike, biseksuale ose transgjimore (LBT).⁷

⁵ E cila sipas nenit 3, parag. 1.7 të Ligjit për Barazinë Gjinore përkufizohet si "karakteristikat biologjike dhe fiziologjike të cilat përcaktojnë meshkujt dhe femrat".

⁶ Ligji për Barazinë Gjinore e përkufizon 'identitetin gjinor' si një "karakteristikë të mbrojtur që mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi, dukjen ose karakteristikat e tjera që lidhen me gjininë e personit (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike ose jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje" (neni 3, parag. 1.9).

⁷ I njëjti ndalim parashikohet me nenin 4 të Ligjit për Barazinë Gjinore.

Barazia gjinore

Barazia gjinore nuk u referohet vetëm të drejtave të barabarta, por përfshin dukshmërinë, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e barabartë për burrat dhe gratë në të gjitha fushat e jetës. Barazia gjinore vlerëson dallimet individuale dhe promovon dinamikën e balancuar të pushtetit, duke njohur larminë ndërmjet klasës, fesë, përkatësisë etnike dhe orientimit seksual (Këshilli i Evropës, Strategjia e Barazisë Gjinore 2024-2029, 2024, 5-10).

Është e rëndësishme të theksohet se shqip, ‘barazia gjinore’ (*gender equality*) ka një kuptim të dyfishtë: ajo përfshin si barazinë (e drejta e rezultatit të barabartë për gratë dhe burrat) ashtu edhe procesin e arritjes së kësaj barazie - që në anglisht shpesh quhet ‘gender equity’ (shih më poshtë).

- Një shembull praktik i barazisë gjinore është ofrimi i mundësive dhe i buri-meve të njëjta akademike për të gjithë nxënësit, pavarësisht gjinisë. Kjo do të thotë sigurimi i qasjes së barabartë në lëndët STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), programet sportive dhe aktivitetet jashtëmësimore. Gjithashtu, përfshin ofrimin e të njëjtit inkurajim dhe mbështetje në përzgjedhjen e çdo fushe studimi a karriere, duke çuar në thyerjen e barrierave gjinore dhe në sigurimin që të gjithë nxënësit të arrijnë potencialin e tyre të plotë (UNDP, 2022).

Gender equity (në anglisht)

Edhe pse ‘gender equality’ dhe ‘gender equity’ në gjuhën angleze përdoren shpesh si terma sinonimë, është e rëndësishme të bëhet dallimi: ndërsa barazia gjinore (*gender equality*) nënkupton rezultate të barabarta për gratë dhe burrat, termi ‘gender equity’ i referohet procesit të arritjes së kësaj barazie (16 Ditët e Aktivizmit, 2023). Konventa e Stambollit, megjithëse nuk e përmend shprehimisht, promovon ‘gender equity’ përmes thirrjes për eliminimin e diskriminimit dhe avancimin e barazisë (Neni 4(2)).

U tha se në gjuhën shqipe nuk ka një term të drejtpërdrejtë për ‘gender equity’. Për rrjedhojë, termi ‘barazi gjinore’ e përfshin edhe kuptimin e ‘gender equity’, duke përmbledhur si rezultatit e barabartë ashtu edhe proceset e nevojshme për ta arritur atë. Kjo qasje e dyfishtë reflektohet edhe në Ligjin për Barazi Gjinore në Kosovë, i cili – megjithëse nuk e përmend drejtpërdrejt nocionin ‘gender equity’ – përcakton dispozita mbi trajtimin e barabartë, mundësitë e barabarta dhe masat e përgjithshme e të veçanta.

- Për shembull, në një shkollë barazia gjinore mund të nënkuptojë që vajzat dhe djemtë të kenë mundësi të barabarta për bursa, duke siguruar kështu qasje të barabartë në arsim. Ndërsa ‘gender equity’ nënkupton adaptimin e mbështetjes sipas nevojave specifike të secilës gjini. Në rast se vajzat janë të nënpërfaqësura në një fushë të caktuar, një qasje e bazuar në ‘gender equity’ mund të ofrojë programe mentorimi ose bursa shtesë për to, duke synuar krijimin e një terreni të barabartë dhe adresimin e pabarazive ekzistuese (TëVë).

Megjithëse “barazia” siguron të drejta të barabarta, ka raste kur ‘equity’ keqpërdoret për t’i forcuar stereotipat dhe rolet gjinore tradicionale, duke nënkuptuar se gratë duhet të trajtohen “drejt” në bazë të stereotipave ekzistues. Kjo mund të ruajë marrëdhëniet e pabarabarta gjinore dhe të forcojë stereotipa të dëmshëm (European Institute for Gender Equality). Kur trajtohet barazia gjinore, është me rëndësi të kihet parasysh jo vetëm ofrimi i mundësive të barabarta për të gjitha gjinitë, por edhe nevojat dhe rrethanat e veçanta që mund të ndikojnë në arritjen e kësaj barazie. Barazia gjinore përfshin si qëllimin për rezultate të barabarta, ashtu edhe vëmendjen ndaj proceseve të drejta dhe gjithëpërfshirëse që çojnë tek ato rezultate. Kujdesi në përdorimin dhe kuptimin e këtij koncepti ndihmon në shmangien e përsëritjes së stereotipave të vjetër dhe në fuqizimin e një qasjeje të ndjeshme e të drejtë ndaj dallimeve gjinore.

- Për shembull, nëse një vend pune ofron pushim më të gjatë lehonie vetëm për gratë⁸, mund të duket e drejtë (barazi (equity)), por përforcon stereotipin se kujdesi për fëmijët është kryesisht përgjegjësi e gruas. Kjo praktikë mund të jetë e parashikuar në ligj, ose mund të jetë politika e një vendi pune. Sido që të jetë, kjo mund ta përjetësojë idenë se burrat nuk duhet ose nuk mund të marrin role të kujdesit, duke ruajtur kështu dinamika të pabarabarta gjinore. Një qasje më e ekuilibruar do të inkurajonte pushimin e përbashkët prindëror, duke promovuar barazinë si në përgjegjësitë e përkujdesjes ashtu edhe në përgjegjësitë profesionale (Banjska et al., 2019, 47-48). Për shembull, “Direktiva e Ekuilibrit Punë-Jetë” evropiane garanton pushimin e atësisë dhe pushimin prindëror për punonjësit që janë prindër dhe synon të trajtojë nënëpërfaqësimin e grave në tregun e punës, të ndihmojë me ekuilibrin mes punës dhe jetës familjare të tyre dhe të nxisë një shpërndarje më të mirë të përgjegjësiave të kujdesit midis grave dhe burrave (Kern V. & Lecerf M., 2023).

Stereotipet gjinore

Neni 12(1) i Konventës së Stambollit u bën thirrje shteteve të eliminojnë paragjykimet dhe zakonet që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose i përforcojnë rolet e stereotipizuara. Stereotipet gjinore⁹, të cilët imponojnë pritshmëri strikte se si duhet të sillen individët, pengojnë barazinë gjinore (Këshilli i Evropës, pa datë, Luftimi i Stereotipeve Gjinore dhe Seksizmit). “**Stereotipet gjinore**” janë modele ose ide sociale a kulturore të paramenduara, me anë të të cilave grave dhe burrave u caktohen karakteristika dhe role të përcaktuara dhe të kufizuara nga seksi i tyre (Këshilli i Evropës, Strategjia e Barazisë Gjinore, 2024, 23). Stereotipet e tillë kufizojnë shprehjen personale dhe përforcojnë normat e vjetruara, duke kufizuar përparimin drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

⁸ Neni 49 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, i vitit 2010, u jep grave të punësuar pushim lehonie 12-mujor. Neni 50 saktëson se të drejtat e përcaktuara në nenin 49 të këtij ligji mund t’i ushtrojë edhe babai i fëmijës, në rastet e sëmundjes së nënës, braktisjes së fëmijës nga nëna dhe/ose vdekjes së nënës.

⁹ Neni 3 paragraf. 1.22 i Ligjit për Barazi Gjinore përcakton një përkufizim të ngjashëm të ‘stereotipave gjinorë’.

- Një shembull praktik i stereotipit është supozimi se djemtë nuk duhet të qajnë dhe vajzat janë më emocionale. Ky stereotip përforcon idenë se djemtë duhet të jenë gjithmonë të ashpër dhe t'i fshehin ndjenjat, ndërsa vajzat duhet të jenë emocionalisht më shprehëse. Shkollat mund të kundërshtojnë stereotipet e roleve gjinore duke mësuar se të gjitha emocionet janë të vlefshme për të gjithë dhe duke inkurajuar djemtë dhe vajzat t'i shprehin ndjenjat haptazi dhe pa turp (Greig, 2016)

Diskriminimi i ndërlidhur

Koncepti i diskriminimit të ndërlidhur (Crenshaw, 2019) thekson se të gjitha format e shtypjes janë të ndërlidhura (Taylor, 2019). Edhe pse nuk përmendet në mënyrë eksplicite, neni 4(3) i Konventës së Stambollit pranon se gratë përballen me forma të shumta dhe të ndërlidhura të diskriminimit bazuar në racë, fe ose status të tjera. Ai thekson se mbrojtja ndaj dhunës duhet të jetë jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse.¹⁰

- Një shembull praktik i diskriminimit të ndërlidhur në Kosovë mund të përfshijë një vajzë nga komunitetet pakicë, që përballlet me shtresa të shumëfishta të diskriminimit. Ajo mund të hasë në paragjykime jo vetëm për shkak të seksit, por edhe për shkak të përkatësisë etnike. Për shembull, mund të hasë në pengesa për qasjen në arsim për shkak të normave diskriminuese gjinore, që i japin përparësi arsimimit të djemve në komunitetin e saj, të kombinuara këto me diskriminimin etnik, që ia kufizon mundësitë në shoqërinë më të gjerë (Banjska et al., 2019).

¹⁰Neni 4 parag. 1.10 i Ligjit të Kosovës për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton se "diskriminimi i shumëfishtë ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe bazat e shumëfishta interpretohen në përputhje me rrethanat".

MODULI 2:

Të kuptuarit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Ky Modul ofron shembuj praktikë të koncepteve thelbësore për të kuptuar dhe parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Ai është krijuar që të jetë i përshtatshëm dhe i zbatueshëm për të gjithë personelin e shkollës, duke përfshirë përgjegjësinë kolektive në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Dhuna ndaj grave

Përkufizimi i Konventës së Stambollit për **dhunën ndaj grave** përfshin, por pa u kufizuar në to, akte si dëmtimi fizik, seksual, psikologjik dhe ekonomik, dhunën e vërtetë si dhe kërcënimet për një dhunë të tillë. Kjo përfshin dhunën në familje dhe atë seksuale, ku hyjnë përdhunimi, ngacmimi seksual, dhuna e kryer në emër të ‘nderit’, gjymtimi i organeve gjenitale femërore, martesë e detyruar, ndjekja, aborti i detyruar dhe sterilizimi i detyruar, si dhe trafikimi për shfrytëzim seksual (*shih* më shumë nën **Format e dhunës**).¹¹ Përkufizimi i ‘**grave**’¹² në Konventën e Stambollit sqaron se përfshin vajzat nën moshën 18 vjeç (neni 3(f)).

Shënim i rëndësishëm: Emrat e përdorur në shembujt e këtij Udhëzuesi janë vetëm për qëllime ilustrimi dhe nuk i referohen ndonjë individi specifik. Këta shembuj janë menduar për t’i ndihmuar mësimdhënësit me të kuptuarit e formave të dhunës ndaj grave dhe me zbatimin e Konventës së Stambollit në mënyrë profesionale dhe të ndjeshme, por nuk synohen për t’u përdorur drejtpërdrejt në mësimdhënie me nxënësit. Këta shembuj shërbejnë si mjet mësimor për vetë mësimdhënësit, që t’i kuptojnë më mirë konceptet dhe t’i zhvillojnë aftësitë për identifikim, reagim dhe referim të rasteve të dhunës në kontekstin shkollor.

¹¹ Përkufizimi i njëjtë i DhNG-së është dhënë në nenin 3, paragraf 1.2 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga DhF, DhNG dhe DhBGJ.

¹² Neni 3 paragraf 1.2 i Ligjit për Barazi Gjinore e përkufizon ‘gruan’ si “çdo person që konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor”.

- **Shembull:** Znj. Hana, mësuese e klasës së pestë, vëren se një nga nxënëset e saj, Nora, shpesh flet për mënyrën se si e ëma i duket e trishtuar dhe e frikësuar kohët e fundit. Nora përmend se nëna i shmanget daljeve sepse ka frikë nga dikush. Znj. Hana e pyet me butësi Norën më shumë për atë që ka ndodhur. Nora shpjegon se mamanë po ia ngacmon një fqinj, i cili sa herë e sheh bën komente kërcënuese. Ky ngacmim vazhdon prej muajsh dhe megjithëse nëna e Norës është përpjekur të shmangë fqinjin, situata e ka bërë të ndihet e pasigurt jashtë dhe brenda shtëpisë.

Nëna e Norës po përjeton dhunë në formën e ngacmimit nga fqinji. Ky është një shembull i dhunës ndaj grave, sepse është akt dhune me bazë gjinore që ndodh në një kontekst publik (jashtë shtëpisë) dhe shënjestron nënën e Norës.¹³

Dhuna në familje (DhF)

Përkufizimi i Konventës së Stambollit për “**dhunën në familje**”¹⁴, i cili përfshin dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, pranon se të gjithë individët – gra dhe burra, vajza dhe djem, dhe njerëz jo konform gjinisë – mund të jenë viktimë të dhunës në familje. Sjellja kontrolluese shtrënguese është kur një model i akteve të dhunës, si sulmi, kërcënim, poshtërimi, izolimi, monitorimi ose frikësimi, përdoret për të dëmtuar, ndëshkuar ose frikësuar dikë dhe për t’ia mohuar lirinë.

- **Shembulli 1:** Znj. Drita është mësuese e matematikës. Një ditë, ajo vëren se njëra nga nxënëset e saj, Arta, po bëhet gjithnjë e më e tërhequr dhe po duket e shqetësuar gjatë orës së mësimi. Po ashtu, Arta ka munguar më shpesh në shkollë dhe kur ndjek mësimin, shfaqet e lodhur dhe e papërqendruar. E shqetësuar, znj. Drita vendos të flasë privatisht me Artën për të vëzhguar mirëqenien e saj. Gjatë bisedës, Arta tregon me ngurrim se babai e ka abuzuar verbalisht nënën në shtëpi. Ky abuzim shpesh përfshin bërtimat, kërcënimet, thyerjen e gjërave dhe mbylljen e nënës në shtëpi kur ai vetë del jashtë. Edhe pse Arta nuk e ka parë asnjëherë babain ta godasë nënën apo ta lëndojë fizikisht, kërcënimet e vazhdueshëm dhe trazirat emocionale e kanë prekur thellë.

Në këtë skenar, nëna e Artës është viktimë e dhunës në familje, pasi abuzimi verbal, kërcënimet, shkatërrimi i pasurisë dhe izolimi bien në përkufizimin e **dhunës në familje** sipas Konventës së Stambollit. Gjithashtu, megjithëse Arta nuk është dëmtuar fizikisht, edhe ndikimi psikologjik i dëshimit të kësaj dhune njihet si formë e dhunës në familje.

¹³ Neni 248/A i Kodit Penal të Kosovës e inkriminon dhunën ndaj grave në jetën publike si vepër penale të dënueshme.

¹⁴ Përkufizimi i DhF-së në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga DhF, DhNG dhe DhBGJ është “të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin brenda marrëdhënies në familje, ose njësisë shtëpiake, pavarësisht nga lidhja e gjakut apo marrëdhënies familjare, ose nga ish-partneri intim ose partneri intim aktual, pavarësisht nga fakti nëse ushtruesi i dhunës ndan apo ka ndarë të njëjtin banim me viktimën me qëllim të cenimit të dinjitetit dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm dhe pozitë varësie, personat ndaj të cilëve është ushtruar dhuna”.

● **Shembulli 2:** Mësuesja Flora vëren se nxënësi i saj, Arbeni, i cili ka nota të larta dhe sillet mirë në shkollë, shpesh vjen herët, nuk shoqërohet fort me fëmijët e tjerë dhe duket se ngurron të largohet kur mbaron mësimi. E shqetësuar për mirëqenien e Arbenit, mësuesja Flora e pyet nëse gjithçka është në rregull në shtëpi. Arbeni i tregon se e ëma, Lira, përballet me dhunë të shpeshtë nga i ati. Babai i Arbenit i bërtet asaj shpesh, e godet me shuplakë e shkelma, e kap nga fyti dhe e shtyn. Arbeni, thellësisht i prekur nga ky abuzim, ndihet i frikësuar dhe i pafuqishëm në shtëpi dhe thotë se babai, kur zemërohet, e godet edhe atë.

Në rastin e Arbenit, nëna është viktimë e dhunës në familje, që pëson dëmtime fizike dhe psikologjike nga bashkëshorti. Ndërkohë, Arbeni konsiderohet viktimë edhe sipas Konventës së Stambollit, sepse është dëshmitar i dhunës dhe rrjedhimisht vuan emocionalisht, si dhe është abuzuar fizikisht nga i ati.

Dhuna në familje, e cila mund të përfshijë dhunë nga partneri intim ose dhunë ndërmjet brezave, është çështje komplekse që shpesh perceptohet si private. Megjithatë, kjo lloj dhune është shkelje serioze e të drejtave të njeriut dhe secili ka një rol për të luajtur në sfidimin e abuzimit të tillë.

Në vend që të pyesim pse viktimat nuk largohen, duhet të pyesim: pse nuk ndalohen autorët e dhunës. Presionet sociale, mbështetja e pamjaftueshme e shtetit dhe rreziqet me të cilat përballet viktimat kur largohet, komplikojnë aftësinë e saj për t'u larguar. Taktikat e zakonshme të kontrollit, të kombinuara me pritshmëritë sociale – si besimi se çfarëdo lloj figure e babait është më e mirë se asnjë – mund ta bëjnë më të vështirë largimin. (aMeron *et al.*, 2022, 683-687; Dinisman & Moroz, 2019, 22-25; 48-51).

Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) ndaj grave

Përkufizimi i dhunës me bazë gjinore është i dallueshëm, sepse synon në mënyrë të veçantë gratë ose i prek ato në mënyrë më të theksuar për shkak të gjinisë. Kjo dhunë buron prej dinamikës së pabarabartë të pushtetit midis burrave dhe grave, dhe e përforcon atë, çka përjetëson pozitën vartëse të grave në jetën publike e private dhe në fund kontribuon në pranimin shoqëror të një dhune të tillë (Pandea *et al.*, 2019, 17-18).

- **Shembull:** Besa po bëhet gjithnjë e më e tërhequr dhe më pak e sigurt në klasë. Dikur entuziaste për pjesëmarrje në aktivitetet e klasës, Besa tani ngurron të flasë dhe shpesh duket e mërzhitur. E shqetësuar, znj. Drita, mësuesja e klasës së saj, vendos të bëjë një bisedë private për të zbuluar se çka e shqetëson Besën. Gjatë bisedës, Besa tregon se disa djem të klasës e ngacmojnë vazhdimisht, duke e tallur se është vajzë dhe i thonë se disa gjëra ajo nuk mund t'i bëjë sepse “vajzat janë të dobëta”. Madje në disa raste ia kanë marrë edhe ushqimin e drekës, duke i thënë se vajzat nuk kanë nevojë për ushqim aq sa djemtë. Besa ndihet e lënduar, e turpëruar, dhe ky ngacmim e ka bërë të ketë frikë të vijë në shkollë. Në rastin e Besës, ngacmimi që ajo përjeton është formë e dhunës me bazë gjinore, sepse buron nga stereotipa të dëmshëm gjinorë. Djemtë e kanë në shënjestër Besën sepse është vajzë, dhe përdorin gjininë e saj si bazë për ta poshtëruar, përjashtuar e frikësuar. Kjo sjellje jo vetëm që ndikon në mirëqenien emocionale të Besës, por edhe i përforcon qëndrimet diskriminuese për rolet gjinore.

Format e dhunës

Konventa e Stambollit thekson se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje shpesh rrjedhin nga dinamika e pabarabartë e pushtetit. Këto dinamika çojnë në kulturë të heshtjes, pasi viktimat i frikësohen hakmarrjes.

Adresimi i këtyre dinamikave të pushtetit është kyç për të krijuar një mjedisi arsimor të sigurt dhe mbështetës. Kjo përfshin zbatimin e politikave strikte kundër ngacmimit, dhunës dhe abuzimit, ofrimin e trajnimeve gjithë stafit për njohjen dhe parandalimin e abuzimit dhe krijimin e mekanizmave të qartë të raportimit, si dhe mbështetjeje për viktimat. Konventa e Stambollit (neni 41) thekson edhe se ndihma, nxitja dhe tentativa për të kryer vepra penale që lidhen me dhunë të tillë (të përshkruara në nenet 33-39) duhet të penalizohen.

Dhuna shpesh shtrihet përtej dëmtimit fizik, duke përfshirë forma të ndryshme jofizike si: dhuna psikologjike, dhuna ekonomike, ndjekja ose dhuna në dimensionin digjital. Në praktikë, forma të shumta të dhunës shpesh ndërthuren, veçanërisht dhuna në familje. Këto forma mund të ndodhin brenda mjediseve private (si familja dhe marrëdhëniet intime) dhe hapësirave publike, e të kryhen nga individë, organizata, institucione ose entitete shtetërore (Butler & Hrytsenko, 2024). Konventa e Stambollit identifikon disa forma të dhunës si:

Dhuna psikologjike (neni 33)

Të gjitha format e dhunës kanë një aspekt psikologjik, duke synuar të cenojnë integritetin dhe dinjitetin e një personi. Disa lloje janë krijuar posaçërisht për të shkaktuar dëme psikologjike pa abuzim fizik ose verbal, si p.sh. izolimi, moszbulimi i informacionit thelbësor, përhapja e informacionit të rremë dhe përfshirja në sjellje kërcënuese.¹⁵

¹⁵ Neni 3 parag. 1.8 i Ligjit të Kosovës për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga DhF, DhNG dhe DhBGj përcakton që ‘dhuna psikologjike’ përfshin kontrollin e vazhdueshëm, keqtrajtimin verbal, izolimin, poshtërimin ose abuzimin emocional përmes sharjes, ofendimit, shantazhit, frikësimit, përcjelljes dhe vëzhgimit të vazhdueshëm, fshehjen e informacionit, dezinformimin dhe sjelljen kërcënuese, trajtimin degradues, kanosjen ose format e ngjashme të kontrollit të presionit psikik, duke e vënë një person nën frikë të arsyeshme nga përdorimi i dhunës ndaj tij/saj ose ndaj personave në marrëdhënie familjare, nga kërcënimet për dëmtimin e pasurisë ose mbajtja nën shqetësim të vazhdueshëm emocional”.

Në rrafshin privat, dhuna mund të përfshijë kërcënime joverbale, duke iu referuar neglizhencës së qëllimshme, ndërsa në atë publik, shpesh manifestohet si përjashtim social që i synon ata që sfidojnë rolet tradicionale gjinore. Ky lloj përjashtimi mund të kryhet nga kolegët ose figurat e autoritetit si mësimdhënësit dhe trajnerët dhe mund të përfshijë frikësim ose mohim të pjesëmarrjes në aktivitetet e grupit (Pandea *et al.*, 2019, 26).

Fjalët e një dhunuesi mund të përdoren për të frikësuar, manipuluar, poshtëruar ose për të shkaktuar lëndime ose mërzitje. Kjo mund të përfshijë fyerje, tallje, gjuhë nënçmuese ose komente që atakojnë identitetin e një personi, si feja, kultura, gjuha ose orientimi seksual i tyre. Për gratë dhe vajzat, një abuzim i tillë shpesh merr formë të seksualizuar dhe bie nën kategorinë e dhunës ose ngacmimit seksual.¹⁶

● **Shembulli 1:** Nëse dikush vazhdimisht nxjerr në pah mosmarrëveshjet ose gabimet e mëparshme, duke synuar të ngjallë frikë ose pasiguri, tregon përfshirjen në abuzim psikologjik. Për më shumë, injorimi ose neglizhimi i qëllimshëm i nevojave dhe i emocioneve të një partneri, si mosnjohja e arritjeve të saj/tij ose shmangia e komunikimit gjatë periudhave të shqetësimit emocional, gjithashtu përbën dhunë psikologjike. Kjo formë e abuzimit synon të gërryjë vetëvlerësimin dhe ndjenjën e sigurisë së partnerit pa iu drejtuar konfrontimit fizik ose të drejtpërdrejtë verbal (Beeden, 2023).

Shembulli 2: Një i ri, që shpreh identitet gjinor jotradicional, mund të mos pëlqehet nga grupi i bashkëmoshatarëve, të përjashtohet nga ngjarjet shoqërore ose të lihet jashtë aktiviteteve të ekipit. Kjo formë e abuzimit psikologjik mund të kryhet edhe nga figura të autoritetit, si mësimdhënësit ose trajnerët e sportit, të cilët mund të frikësojnë ose përjashtojnë qëllimisht individin nga pjesëmarrja në grup, duke kontribuar në marginalizimin e tyre dhe shqetësimin emocional (Clearinghouse for Sports. 2022).

Përndjekja (neni 34)

Neni 34 i Konventës së Stambollit kërkon penalizimin e përndjekjes, e cila përkufizohet si sjellje kërcënuese e përsëritur, e drejtuar ndaj një personi tjetër, që e bën atë të ketë frikë për sigurinë e vet. Ai e identifikon përndjekjen si formë dhune ndaj grave, pasi ajo ndodh shpesh pas përfundimit të një marrëdhënieje abuzive, duke nxjerrë në pah natyrën e saj gjinore. Megjithatë, gratë shpesh përndiqen edhe nga burra me të cilët nuk kanë qenë kurrë në lidhje (Këshilli i Evropës, 2019, Përndjekja).

¹⁶Neni 3 parag. 1.16 i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga DhF, DhNG dhe DhBGj përcakton se viktimat të cenueshme mund të jenë “vajzat dhe gratë, fëmijët, të miturit, LGBTQ+, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, gratë shtatzëna, të moshuarit dhe ai person, marrëdhënia familjare ose varësia e të cilit nga pala përgjegjëse e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, kërcënimit ose hakmarrjes”.

● **Shembulli 1:** Gruaja i jep fund marrëdhënies me partnerin. Pavarësisht prej ndarjes, ai fillon ta ndjekë nga pas kur kjo shkon në punë, të presë jashtë shtëpisë së saj dhe t'i dërgojë mesazhe e telefonata të vazhdueshme. Sjellja e tij përshkallëzohet deri aty sa shfaqet i paftuar në mbledhitë e saj shoqërore. Ndonëse ajo shpreh frikë e shqetësim dhe i thotë të ndalet, ai vazhdon.

Shembulli 2: Një gjimnaziste bëhet shënjestra e një moshatari. Edhe pse nuk kanë qenë asnjëherë të afërt, ai fillon ta ndjekë nëpër rrjetet sociale, duke i dërguar mesazhe të shpeshta e të padëshiruara dhe komente në postime. Shfaqet edhe në vendet që ajo frekuenton, si kafene e palestra. Vëmendja e tij nis të përjetohet si pushtuese, veçmas kur fillon t'i vihet pas aktivitetit të saj në internet, duke reaguuar ndaj gjithçkaje që ajo poston. Pavarësisht nga kërkesat e saj që të ndalet, ai vazhdon dhe veprimet e tij bëhen gjithnjë e më shqetësuese. Kjo lloj ndjekjeje tregon se si mjetet digjitale mund të përdoren për t'ia pushtuar privatësinë dikujt, edhe kur ndjekësi njihet, por nuk është afër viktimës. (Këshilli i Evropës, 2019, Përndjekja)

Dhuna fizike (neni 35)

Dhuna fizike përdoret për të shkakuar kontroll, dhimbje dhe/ose lëndim fizik. Kjo mund të përfshijë grushtimin, shuplakën, goditjen, shkelmimin ose kafshimin, mbytjen ose ngufatjen, shkuljen e flokëve, pështyrjen, frenimin, grushtimin e mureve ose thyerjen e sendeve, ose përdorimin e objekteve si armë.

Ngjashëm, marrëdhëniet intime mes të rinjve mund të përfshijnë dhunë fizike dhe kjo, për të gjitha moshat, mund të shoqërohet me dhunë psikologjike dhe seksuale. Dhuna e tillë rrjedh nga paragjykimet shoqërore dhe shpesh mbetet dobët e raportuar për shkak të ndikimit që ka në sigurinë dhe sjelljen e viktimave (Pandea *et al.*, 2019, 24).

Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin (neni 36)

Dhuna seksuale rrjedh nga abuzimi i pozitës së pushtetit. Ajo ngërthen një sërë veprimesh, duke përfshirë depërtimin pa pëlqim me cilëndo pjesë të trupit a me objekt dhe akte të tjera seksuale jokonsensuale, përfshirë edhe detyrimin që involvon një palë të tretë. Dhuna seksuale përfshin dhunimin, sulmin seksual, abuzimin seksual dhe ngacmimin seksual (Format e dhunës seksuale).¹⁷ Përdhunimi (martesor e jomartesor), tentativa e përdhunimit përfshihen në këtë kategori, si dhe aktivitetet seksuale të detyruara si vojerizmi pa pëlqim, masturbimi publik, seksi i detyruar i pasigurt, shtatzënia e detyruar, aborti i detyruar, gjymtimi i organeve gjenitale femërore dhe sterilizimi. Në sferën publike, dhuna verbale me bazë gjinore shpesh përfshin komentet nënçmuese dhe shakatë që i reduktojnë gratë në objekte seksuale ose përjetësojnë stereotipa të dëmshëm. Dhuna seksuale nuk kufizohet në

¹⁷ Akte të dënueshme penale sipas Kodit Penal të Kosovës: neni 227 – Dhunimi; neni 184 – Sulmi; neni 143, parag. 1(1.7) – Dhunim, skllavëri seksuale, prostitucion i detyruar, shtatzëni me dhunë, sterilizim i detyruar ose çfarëdo forme tjetër po aq e rëndë e dhunës seksuale; neni 179 – Sterilizimi i detyruar.

hapësirat private, por manifestohet edhe në kontekste publike, siç është për shembull ngacmimi në vendin e punës. (Pandea *et al.*, 2019, 26-27).

Martesa e detyruar (neni 37)

Martesa e detyruar ndodh kur njëri ose të dy personat nuk japin pajtimin (ose nuk munden, nëse nuk kanë aftësi) për martesën dhe ata detyrohen me presion ose i nënshtrohen abuzimit për t'u martuar.¹⁸ Këtë mund t'ua bëjnë familja, të afërmit ose anëtarët e komunitetit. Presioni ose dhuna e përdorur mund të jetë fizike ose psikologjike, e në disa raste, dikush në rrezik të martesës së detyruar mund të mos ndihet “i detyruar”, por njëkohësisht, nuk mund të thotë jo ose mund të ketë frikë nga pasojat nëse martesa nuk lidhet.

Neni 37 i Konventës së Stambollit kërkon zbatimin e ligjeve që sigurojnë se detyrimi i qëllimshëm i një të rrituri a i një fëmije për martesë, ose shtytja e një të rrituri a e një fëmije për martesë të detyruar në një shtet tjetër, është vepër penale.

Gjymtimi i organeve gjenitale femërore (neni 38)

Shumë vajza dhe gra në mbarë botën kërcënohen me gjymtim të organeve gjenitale ose e përjetojnë atë (GjOGjF).¹⁹ Kjo përfshin “heqjen e pjesshme ose totale të organeve gjenitale të jashtme femërore, ose dëmtime të tjera të organeve gjenitale për arsye jomjekësore” (OBSh, 2025). GjOGjF ka ndikime serioze psikologjike, fizike dhe seksuale, mund t'ia ndërpresë shkollimin një vajze dhe të jetë pararendës i martesës së hershme ose të fëmijëve.

Konventa e Stambollit kërkon sfidimin e qëndrimeve dhe stereotipave që lejojnë GjOGjF dhe penalizimin e tij si praktikë të dëmshme (Këshilli i Evropës, 2019). Mësimdhënësit mund të trajnohen që të mund t'i edukojnë të rinjtë dhe t'i mbështesin të rrezikuarat ose ato që tashmë i janë nënshtruar GjOGjF-së.

Ngacmimi dhe ngacmimi seksual (neni 40)

Konventa e Stambollit i përkufizon ‘**ngacmimin**’ dhe ‘**ngacmimin seksual**’ si “çarëdo forme të *sjelljes* së padëshiruar *verbale*, *joverbale* ose *fizike* të natyrës seksuale, me qëllim ose me efekt të cenimit të dinjitetit të një personi, veçanërisht kur kjo krijon një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fytes”. (neni 40).²⁰

Shembujt verbalë të ngacmimit seksual mund të përfshijnë komentimin seksual për trupin e një personi, parashtrimin e pyetjeve personale në lidhje me jetën sociale ose seksuale të dikujt, komentimin seksual për veshjen, anatominë ose pamjen e një personi, ngacmimin, të gënjerit ose përhapjen e thashethemeve për jetën seksuale a preferencat seksuale të një personi. Shembujt joverbalë të ngacmimeve seksuale mund të përfshijnë, ndër të tjera, vështrimin e një personi lart e poshtë (të njohur si ‘sy

¹⁸ Martesa e detyruar është vepër penale e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës, neni 239.

¹⁹ Veprat penale të dënueshme sipas nenit 180 – Gjymtimi i organeve seksuale femërore i Kodit Penal të Kosovës.

²⁰ Veprat penale të dënueshme sipas nenit 182 dhe nenit 183 të Kodit Penal të Kosovës.

ashensorë’), përndjekjen, bërjen e gjesteve seksuale me duar ose me lëvizjet e trupit, dhe përdorimin e shprehjeve të fytyrës si shkelja e syrit, hedhja e puthjeve ose lëpirja e buzëve. Ngacmimi fizik përfshin prekjen e rrobave, flokëve ose trupit të një personi tjetër, përqafimin, puthjen, përkëdheljen, prekjen ose fërkimin seksual kundrejt një personi tjetër. (Pandea et al., 2019, 30-31).

● Shembull dhe nxitje për reflektim!

Drita, nxënëse 16-vjeçare në një shkollë të mesme të Kosovës, është bërë së fundmi objekt i vëmendjes së padëshiruar të njërit prej shokëve të klasës, Agronit. Gjatë orës së mësimi, Agroni shpesh ia ngul sytë Dritës, duke e bërë të mos ndihet rehat. Ai komenton edhe pamjen e saj, duke thënë gjëra si: “Duhet ta veshësh këtë fund më shpesh” dhe “Dukesh shumë bukur kur skuqesh”. Gjatë pushimeve, Agroni e ndjek Dritën nëpër shkollë, ndonjëherë duke iu afruar aq sa duhet për t’iu fërkuar për krahu ose shpatulle. Ai i ka dërguar mesazhe edhe në rrjetet sociale, ku i kërkon të dalë me të, pavarësisht se Drita qartazi nuk është e interesuar. Drita ndien gjithnjë e më shumë ankth në shkollë dhe ka filluar t’i shmangë disa zona për t’i shpëtuar vëmendjes së Agronit. Ajo nuk i ka treguar asnjë arsimtari sepse ka frikë se mund të mos e marrin seriozisht ose të mendojnë se po i stërmadhon gjërat.

- Cila nga sjelljet e Agronit mund të klasifikohet si ngacmim ose ngacmim seksual sipas përkufizimeve të dhëna nga Konventa e Stambollit?
- Nëse do të ishte në vend të Dritës, si do t’i përjetoje veprimet e Agronit dhe çka do të mund të të ndalte që ta raportojte te një arsimtar ose këshilltar shkolle?
- Çka mund të bëjnë shkollat për të siguruar që nxënësit si Drita të ndihen të sigurt dhe të përkrahur kur përballen me ngacmime?

Dhuna e kryer në emër të të ashtuquajturit nder (neni 42)

Dhuna e bazuar në ‘nder’ motivohet nga perceptimi se personi ka ‘çnderuar’ ose ‘turpëruar’ veten, familjen a komunitetin, ose mund t’i ‘çnderojë’ a ‘turpërojë’. Kjo është traditë kulturore ose praktikë fetare dhe mund të ndodhë në çdo komunitet, pavarësisht besimit a prejardhjes.

Konventa e Stambollit ndalon në mënyrë eksplicite çdo justifikim të akteve të tilla mbi baza kulturore, fetare, tradicionale ose të ashtuquajtura “nderi” (neni 42). Kjo do të thotë se aktet e dhunës, si vrasja ose plagosja e një gruaje për shkak të devijimit të saj, real ose të perceptuar, nga pritshmëritë kulturore, fetare ose tradicionale, nuk mund të mbrohen mbi këto baza (Këshilli i Evropës, 2019, Fletëpalosje). Konventa e Stambollit bën thirrje për mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat dhe mësimdhënësit duhet të jenë të përgatitur për t’i identifikuar shenjat e mundshme të rrezikut dhe shenjzimet për shërbimet mbështetëse, si dhe të dinë se si t’i raportojnë ato tek autoritetet përkatëse.

● Shembull:

Arta është një grua që jeton në një fshat të Kosovës me bashkëshortin, Besimin. Ata janë të martuar tash pesë vjet dhe kanë dy fëmijë të vegjël. Ndonëse jeta e tyre familjare mund të duket normale së jashtmi, Arta shpesh ndihet e kontrolluar dhe e palumtur. Besimi pret që ajo të merret vetëm me shtëpinë dhe fëmijët, ndonëse Arta zhvillon edhe një biznes të vogël rrobaqepësie nga shtëpia. Besimi nuk merr fare pjesë në kujdesin ndaj fëmijëve, ia kërkon Artës të gjitha paratë që fiton dhe asaj i mbetet shumë pak e drejtë fjale mbi jetën e vet. Sa herë Arta shpreh dëshirat për të mësuar shkathtësi të reja, Besimi e shkurajon, duke i thënë se kjo do ta çnderonte atë si kryefamiljar dhe se roli i saj është vetëm ta mbështesë familjen në shtëpi. Ndonjëherë, ai e bën të ndihet e pavlerë, duke e nënçmuar dhe duke mos e lejuar të marrë vendime, e ndonjëherë edhe e rreh kur mendon se nuk e ka respektuar. Arta i do shumë fëmijët e vet, por ndihet e frikësuar dhe e bllokuar, financiarisht varet nga Besimi dhe nuk di as ku të drejtohet për ndihmë. Arta nuk dëshiron ta turpërojë familjen duke kërkuar ndihmë dhe ka frikë nga reagimet shoqërore të atyre që besojnë se gruaja duhet të qëndrojë me burrin për t'ia ruajtur 'nderin' familjes. Një ditë, një fqinj vëren se Arta duket e pakënaqur dhe i sugjeron të kontaktojë një organizatë që mbështet gratë. Arta i beson fqinjit, i cili është mësimdhënës në shkollën lokale, dhe mëson se shërbimi ofron ndihmë konfidenciale, e ka parasysh "nderin" e familjes dhe jep mbështetje pavarësisht se çka vendos të bëjë Arta. Mësimdhënësi e fton Artën në shkollë për të diskutuar mbi progresin e fëmijës së saj dhe Arta shfrytëzon mundësinë e ofruar që t'i telefonojë linjës së ndihmës dhe t'i shqyrtojë mundësitë e veta.

Dhuna në internet dhe ajo e lehtësuar nga teknologjia

Ndërkohë që shumë forma të dhunës të përshkruara në Konventën e Stambollit ndodhin fizikisht, shumë mund të shtrihen edhe në sferën online. Përkufizimi i 'përndjekjes' në Konventën e Stambollit përfshin ndjekjen në internet dhe atë të lehtësuar nga teknologjia, e cila përfshin kërcënime (të natyrës seksuale, ekonomike, fizike ose psikologjike), dëmtimin e reputacionit, monitorimin dhe mbledhjen e informacionit privat mbi viktimën, vjedhjen e identitetit, kërkesën për seks, imitimin e viktimës dhe ngacmimin me bashkëpunëtorë për ta izoluar viktimën (Këshilli i Evropës, 2021, parag. 41). Më tej, dhuna psikologjike mund të shfaqet si ngacmim digjital, kërcënime ose detyrim nëpërmjet mediave sociale dhe aplikacioneve të mesazheve. Ngacmimi seksual është gjithashtu i përhapur në internet, duke përfshirë komente seksuale të pakërkuara, imazhe dhe ngacmime kibernetike (Këshilli i Evropës, 2024, Udhëzimet e Terminologjisë).

GREVIO thekson se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje që ndodh në sferën digjitale shpesh ndërthuren me dhunën fizike, duke intensifikuar traumën dhe ndonjëherë edhe duke rrezikuar sigurinë fizike të viktimës. Është thelbësore të trajtohet aspekti digjital i abuzimit, veçmas në rastet e dhunës nga partneri intim, pasi abuzimi digjital mund t'i paraprijë ose t'i plotësojë dhunën fizike dhe seksuale, ndjekjen dhe ngacmimin (Këshilli i Evropës, 2021, 15).

MODULI 3:

Qasja e arsimit gjithëpërfshirës

Ky Modul prezanton një qasje të arsimit për të gjithë, e cila integron barazinë gjinore, respektin dhe mosdhunën në të gjithë sistemin arsimor, duke përfshirë kurrikulat, politikat, trajnimin e mësimitdhënësve dhe mjedisin shkollor më të gjerë (Butler & Hrytsenko, 2024, 14-25).

Për ta zbatuar këtë qasje në Kosovë:

- **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)** i integron këto parime në kurrikulë, dhe mund të kërkojë trajnimin e vazhdueshëm të mësimitdhënësve, e të krijojë politika për ta zbatuar atë.
- **Shkollat** mund t'i përfshijnë këto parime në të gjitha lëndët, të sigurojnë materiale të përshtatshme për moshën dhe të krijojnë mjedise mësimore të sigurta dhe mbështetëse.
- **Mësimitdhënësit dhe edukatorët** mund të marrin pjesë në trajnime, të integrojnë barazinë gjinore në punët e tyre të përditshme dhe të bashkëpunojnë me prindërit dhe komunitetin.

[‘Lista e kontrollit për parandalimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet arsimit formal dhe joformal’](#) e KiE-së ofron një mjet praktik për vlerësimin dhe përmirësimin e këtyre strategjive. (Butler & Hrytsenko, 2024).

Burimet dhe materialet mësimore

Materialet mësimore të ndjeshme ndaj gjinisë janë jetike për t'i luftuar stereotipat, dhe burimet aktuale shpesh i përforcojnë ato (Rrjeti i Grave të Kosovës, 2020). MASHTI duhet të sigurojë që materialet didaktike të promovojnë barazinë dhe përfshirjen (Butler & Hrytsenko, 2024, 17). Manuali Metodologjik i Agjencisë për Barazi Gjinore e mbështet këtë zhvillim, ndërkohë që financimi adekuat dhe trajnimi i edukatorëve janë kritikë për zbatim (Agjencia për Barazi Gjinore, pa datë).

Mësimitdhënësit duhet të jenë në gjendje ta njohin dhe ta trajtojnë bullizmin me bazë gjinore dhe të kenë procedura të qarta raportimi sipas PSV-ve. Integrimi i diskutimeve mbi rolet gjinore dhe përdorimi i shembujve të ndryshëm e rrit përfshirjen.

● Si të zbatohet në praktikë qasja për arsim gjithëpërfshirës - nxitje për reflektim

Si mësimdhënës/edukatorë, ju mund të kontribuoni shumë në krijimin e një mjedisi më të barabartë gjinor në klasën tuaj. Kur lexoni tekstin shkollor ose krijoni materiale dhe burime mësimore si mësimdhënës/edukatorë, ju mund të:

- siguroheni që të gjitha gjinitë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në materiale. Shtoni shtesa të ndryshme nëse burimet janë të çekuilibruara. Diskutoni stereotipat kur ata shfaqen dhe nxitini nxënësit të imagjinojnë skenarë jostereotipë.
- Bëni pyetje si: “Pse mendoni se ky rol i caktohet shpesh kësaj gjinie? A mund të mendoni për njerëz që i kundërshtojnë këto norma?”, dhe përdorni lojën me role për t’i sfiduar normat, d.m.th., që vajzat të udhëheqin një eksperiment shkencor ose djemtë të marrin rolet e kujdesit në aktivitetet e klasës.
- Theksoni se si rolet gjinore ndryshojnë rreth kulturave dhe kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Paraqitni shembuj të kontributeve të grave dhe të gjinive të ndryshme, edhe nëse tekstet shkollore i anashkalojnë ato.

Edukimi seksual gjithëpërfshirës (ESGj)

Edukimi seksual gjithëpërfshirës (ESGj), është pjesë përbërëse e një ‘qasjeje për arsim gjithëpërfshirës’, që mbulon tema të përshtatshme për moshën mbi seksualitetin, marrëdhëniet, respektin, pëlqimin dhe autonominë trupore (OBSH, 2023)

Mbrojtja dhe përkrahja

Shkollat duhet të përgatiten për ta trajtuar dhunën, për t’i mbështetur zbulimet e informatave dhe për t’u koordinuar me shërbimet lokale. Mësimdhënësit duhet t’i dokumentojnë shenjat e shqetësimit, të ofrojnë hapësirë të sigurt për nxënësit dhe t’i raportojnë shqetësimet në vijim të protokolleve (Fletëpalosja e Informacionit të Shkollës mbi Procedurën Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje).

Këto veprime janë detajuar në PSV dhe do të shtjellohen më tej në Modulin 5.

Pjesëmarrja, angazhimi i komunitetit dhe puna me zyrat lokale

Angazhimi i fëmijëve, i familjeve dhe i komunitetit është jetik për parandalimin e dhunës dhe nxitjen e barazisë, për shembull nëpërmjet punëtorive, mbështetjes së kolegëve dhe pjesëmarrjes në ngjarje vetëdijesuese. Kjo mund të arrihet për shembull duke planifikuar aktivitete për rastet e ditëve të rëndësishme ndërkombëtare si Dita Ndërkombëtare e Gruas (8 Marsi), ose Dita Ndërkombëtare për

Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (25 Nëntori) dhe 16 ditët pasuese të veprimit për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore (25 nëntor deri në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut më 10 dhjetor) (Butler & Hrytsenko, 2024, 22-23).

- **Propozim:** Shkolla mund të ndërmarrë veprime kundër dhunës me bazë gjinore duke lansuar një fushatë, ku prindërit, bizneset lokale dhe drejtuesit e komunitetit ftohen të marrin pjesë dhe t'i bashkojnë forcat në promovimin e barazisë gjinore dhe në parandalimin e dhunës. Fushata nis me një punëtori që drejtohet nga nxënës të trajnuar mbi temat si marrëdhëniet e shëndetshme dhe stereotipat gjinorë. Personalitete të ndryshme ftohen të ndajnë histori rreth rëndësisë, respektit dhe barazisë. Fushata vazhdon me shkollën që mirëpret nxënës, prindër dhe anëtarë të komunitetit, të cilët punojnë bashkë për të krijuar piktura murale nëpër qytet, duke portretizuar tema të rëndësishme. Të gjitha këto ngjarje mund të mbulohen nga mediat lokale për ta promovuar dhe rritur shikueshmërinë e fushatës.

MODULI 4:

Informacion për të mbështetur planet mësimore

Ky Modul ofron strategji për t'i promovuar barazinë, të menduarit kritik dhe respektin së bashku me zgjidhjen e padhunshme të konflikteve në klasë. Moduli është krijuar posaçërisht për mësimdhënësit që mund të integrojnë këto parime, t'ua përshtatin aktivitetet nevojave të nxënësve, të përdorin shembuj nga jeta reale dhe të promovojnë aktivisht barazinë dhe mosdhunën.

Promovimi i barazisë dhe roleve gjinore jostereotipe

Ndryshimi i narrativës për vajzat, në çdo fushë të jetës, kërkon njëkohësisht ndryshim në narrativën për djemtë (Gratë në Sport, 2024). Stereotipat gjinorë, që nisin në familje dhe më pas përforcohen nga pritshmëritë e shoqërisë, nuk duhet të mbështeten në shkolla. Shkollat duhet të jenë mbrojtëse të forta të barazisë dhe të roleve jostereotipe gjinore; çdo mësimdhënës/edukator luan rol kyç.



Skenari:

Gjatë një turneu të promovimit të librave, autorja [Shannon Hale](#) u përball me skepticizëm lidhur me serinë e saj të librave “Princesha me të zeza” nga një prind që e pyeti pse nuk e shkroi një seri të ngjashme veçmas për djemtë. Hale shpjegoi se librat ishin të destinuar për të gjithë ata që pëlqejnë rrëfimet për një hero, pavarësisht nga gjinia. Pavarësisht përgjigjes së saj, prindi mbeti mosbesues.

Përvojat e Hale-it nuk ndalen këtu. Kur botoi romanin grafik “Miq të vërtetë”, i cili përmban kryesisht personazhe femërore, disa recensues këshilluan të mos u rekomandohej djemve. Një bibliotekare shkolle e prezantoi librin e Hale-it në një tubim me komente që linin të kuptohej se ishte kryesisht për vajza. Gjatë nënshkrimeve të një libri, një nënë shprehu keqardhje që nuk ishte në gjendje t'ua blinte librat djemve, kurse babai i një djali hodhi poshtë një libër të Hale-it si “libër për vajza”.

Këto momente pasqyrojnë besimin më të gjerë kulturor se djemtë nuk do të kënaqen me librat me protagoniste vajza dhe tregimet për burrat konsiderohen universale, ndërsa tregimet për gratë janë vetëm për vajzat (Hale, 2018)

Shkollat pritet të krijojnë mjedise të sigurta, gjithëpërfshirëse, pa paragjykime, bullizime e ngacmime, duke nxitur një kulturë pranimi (për shembull, shih [Let Toys be Toys, 2024](#) (Lodrat le të jenë lodra).

Mësimdhënësit duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë dhe t'i sfidojnë stereotipat gjinorë, që shpesh janë të pavetëdijshëm dhe të rrënjësuar në besime (Instituti i Fizikës IOP, 2019). Ja disa shembuj për të ndihmuar në njohjen dhe adresimin e paragjykimeve në klasë.

● Skenari 1:

Si mësimdhënëës, ju caktoni një projekt të titulluar “Shkencëtar/shpikës i famshëm” në klasën tuaj. Detyra përfshin pyetje si “Kush ishte ai?” dhe jep shembuj ekskluzivisht të shkencëtarëve dhe shpikësve meshkuj si Isaac Newton, Albert Einstein, Alexander Graham Bell dhe Steve Jobs. Ndërsa qëllimi është që t'i prezantojë nxënësit me figura të rëndësishme historike në shkencë dhe shpikje, detyra sugjeron pa dashje që shkencëtarët dhe shpikësit e shquar janë të gjithë meshkuj (Let Toys be Toys, 2024).

Skenari 2:

Si mësimdhënëës, ju keni vendosur t'i vini djemtë belaxhinj që të ulen me vajzat ose pranë tyre. Ky aranzhim synon të nxisë sjellje më të mirë duke shfrytëzuar ndikimin qetësues të perceptuar të nxënësve femra. Megjithatë, duke i vendosur vazhdimisht djemtë pranë vajzave, ju mund ta përforconi pa dashje stereotipin se djemtë janë në thelb të padisiplinuar, ndërsa vajzat bashkëpunuese dhe të rregullta. Kjo praktikë mund të nënkuptojë edhe se është përgjegjësi e vajzës të menaxhojë dhe ‘të kujdeset’ për sjelljen e djemve (shih [Udhëzues për mësimdhënëës për ndjeshmërinë gjinore në klasë, AWARE pa datë](#)).

Skenari 3:

Në klasën tuaj, një nga djemtë fillon të qajë pas një debati me një shok klase. Ju vëreni se disa nxënës reagojnë me komente si: “Hajt pra, djemtë nuk qajnë”, ose “Mos qaj si vajzë”. Si mësimdhënëës, ju vëzhgoni situatën, por zgjidhni të mos trajtoni komentet ose të ndërhyni në ndërveprimin midis nxënësve. Ju vazhdoni me mësimin sikur asgjë nuk ka ndodhur dhe i thoni djalit “Hajde tani, qetësohu”. ([Maulana, 2021](#))

Reflektoni mbi skenarët që mund të përforcojnë stereotipat gjinorë dhe merrni parasysh rastet kur paragjykimi i pavetëdijshëm mund të ketë ndikuar në ndërveprimet e nxënësve. Pasi të identifikoheni, sfidoni këta stereotipa duke përdorur gjuhë gjithëpërfshirëse, duke shmangur frazat që paragjykojnë, duke u angazhuar në diskutime të hapura dhe duke shfaqur modele të ndryshme të roleve (Reeson Education, 2024). Për më shumë udhëzime, referojuni **Modulit 3** mbi qasjen gjithëpërfshirëse në arsim dhe strategjitë shtesë nga [Platforma Evropiane e Trajnimit mbi Dhunën në Familje](#) (ETP në DhF, 2024).

Nxitja e të menduarit kritik

Nxënësit duhet të jenë të përgatitur për t'u përfshirë në të menduarit kritik. Vetëm përmes të menduarit kritik ata do të jenë në gjendje të vënë në dyshim normat dhe t'i formojnë njohuritë. Më poshtë janë disa shembuj se si mund të arrihet kjo.

● Shembulli 1:

Në një orë mësimi historie, kur caktoni leximin e një mësimi të caktuar që mund të shfaqë kryesisht meshkuj në role drejtuese, angazhoni nxënësit në një diskutim kritik rreth kontributit të grave, njerëzve me prejardhje të ndryshme etnike dhe personave me aftësi të kufizuara, rolet e të cilëve mund të jenë anashkaluar.

Shembulli 2:

Merrni lajme nga mediat mbi lojërat e fundit olimpike në Paris, që flasin për të arriturat e sportistëve të xhudos nga Kosova si Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Majlinda Kelmendi, të cilat i sollën medalje vendit. Nxitni diskutime se si portretizohen sportistet femra, sportistët me prejardhje të ndryshme etnike dhe ata me aftësi të kufizuara, në krahasim me sportistët meshkuj, dhe si media mund të përjetësojë ose sfidojë stereotipat.

Shembulli 3:

Gjatë lëndës së edukatës qytetare, ju mund të bisedoni me nxënësit për gratë politike, duke përfshirë politikanet e etnive të ndryshme. Jepuni nxënësve detyra shtëpie duke u kërkuar të hulumtojnë dhe të komentojnë artikujt e lajmeve për politikanë, gra dhe burra, dhe të mendojnë në mënyrë kritike se si media përfaqëson politikanët burra dhe gra dhe ata me prejardhje të ndryshme, duke u fokusuar në mënyrën se si media i përfaqëson, p.sh., si vishen, duken dhe flasin. Përdoreni këtë për të nxitur diskutime se si paragjykimet mediatiche mund të përforcojnë ose t'i thyejnë supozimet raciste, seksiste dhe paragjykimet mbi aftësitë e tyre.

Shembulli 4:

Ju mund të shikoni video që trajtojnë stereotipat gjinorë (kërkoni dhe gjeni në internet). Zgjeroni diskutimet për të eksploruar stereotipat që lidhen me gjininë, racën, aftësinë e kufizuar dhe strukturën e familjes.

Nxitini nxënësit të shprehin mendimet dhe të drejtojnë diskutimet në mënyrë të përshtatshme për moshën, që merr parasysh fazat e tyre të zhvillimit. Kërkoni nga ata të riimagjinojnë skenarë që sfidojnë stereotipat, u ndihmojnë në kultivimin e shkathtësive të të menduarit kritik dhe ua kultivojnë aftësinë për të vënë në dyshim normat gjinore. Kjo u jep nxënësve edhe një ndjenjë pronësie (Chauhan et al., 2022; Vilhjalmsdottir, 2014).

Aktivitete në klasë dhe diskutime

Ky seksion ofron aktivitete në klasë dhe diskutime për mësimdhënësit e klasave 1-9, duke kultivuar mësimin e përshtatshëm për moshën. Burimet si [Rritja e djemve/fëmijëve: Mënyra Feministe](#) (Mackay, pa datë) sugjerojnë sfidimin e normave gjinore duke i trajtuar fëmijët si individë, duke ua lejuar shprehjen emocionale dhe pavarësinë (Mackay, pa datë). [Paketa e mjeteve arsimore të Komisionit të](#)

[BE-së](#) për të ndihmuar në luftimin e stereotipave gjinorë në shkollën fillore (Janeckova et al., 2021) ofron aktivitete konkrete për t'i ndihmuar nxënësit më të vegjël (klasat 1 dhe 2) t'i luftojnë stereotipat.

● Shembulli 1:

Aktiviteti:

- Uluni në qendër të një rrethi dhe hidhnjani një top një nxënësi, duke thënë “vajzat janë...” ose “djemtë janë...”.
- Nxënësi që kap topin përgjigjet me fjalën e parë që i vjen në mendje.
- Regjistroni përgjigjet në dy kolona në tabelë (një për vajzat, një për djemtë).
- Përsëriteni derisa të keni përgjigje të mjaftueshme për të diskutuar.

Filloni një seancë informuese, duke lexuar përgjigjet në tabelë me zë të lartë dhe duke diskutuar me grupin:

- A mendoni se vajzat dhe djemtë duhet të veprojnë sipas fjalëve në tabelë?
- A mund të bëjnë djemtë dhe vajzat gjëra nga të dyja listat?
- A besoni se ata mund të sillen në mënyra të ngjashme?

Pyesni nxënësit nëse janë dakord që vajzat mund të shijojnë futbollin, djemtë mund të pjejnë, vajzat mund të udhëheqin dhe djemtë mund të jenë të ndjeshëm.

Shpjegoni konceptin e stereotipave gjinorë (p.sh. djemtë janë të zhurmshëm, vajzat preferojnë kukullat), duke theksuar rëndësinë e të parit të njerëzve si individë dhe jo përmes stereotipave ose supozimeve të bazuara në gjini (Janeckova *et al.*, 2021, 14).

Shembulli 2:

Jepni një listë të punëve të zakonshme si larja e enëve, hedhja e mbeturinave, gatimi, hekurosja, riparimi i gjërave, kujdesi për fëmijët dhe të ngjashme. Kërkoni nga secili nxënës t'i vizatojë anëtarët e familjes (duke përfshirë veten). Kërkoni nga nxënësit të identifikojnë se kush i bën secilën punë në shtëpinë e tyre. Për nxënësit më të vegjël (p.sh., klasa 1), përdorni imazhe të punëve për t'u përshtatur me anëtarët e familjes, në vend që të shkruani. Nxënësit krahasojnë rezultatet në grupe.

Filloni të diskutoni me nxënësit duke bërë pyetjet e mëposhtme:

- Cilët janë të rriturit ose kujdestarët në shtëpinë tuaj dhe çfarë punësh bëjnë ata? A ndahen punët në mënyrë të barabartë?
- A ndihmon ti me punët e shtëpisë? A të ndihmojnë vëllezërit e motrat në të njëjtën mënyrë?
- A kanë anëtarët e familjes tënde kohë të lirë për hobi? Nëse jo, pse?

Mësimdhënësit mund të sfidojnë disa nga përgjigjet e nxënësve (Janeckova *et al.*, 2021, 39-40).

● Shembulli 3:

Krijoni një listë deklaratah në lidhje me gjininë (p.sh. “Të gjithë djemtë pëlqejnë të luajnë jashtë”, “vajzave u pëlqen të veshin fustan”, “disa vajzave u pëlqen të luajnë me kamionë”). Ndryshoni ose shtoni deklarata sipas nevojës.

Lexoni çdo deklaratë me zë të lartë. Nëse nxënësit janë dakord, ata ngrenë dorën; nëse nuk pajtohen, i mbajnë duart ulur. Numëroni duart e ngritura.

Pasi të mblidhen përgjigjet, mësimdhënësi do të fillojë një seancë informuese dhe do t’u bëjë nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Cilat deklarata kishin më shumë pajtime apo mospajtime?
- Ishte e lehtë të përgjigjeshit?
- Si ju bëjnë të ndiheni këto deklarata?

Diskutim:

Shpjegoni stereotipat gjinorë - besimet e zakonshme për mënyrën se si djemtë dhe vajzat “do të duheshin” të silleshin. Rilexoni pohimet dhe kërkojuni nxënësve të identifikojnë se cilat janë të bazuara në stereotipa. Nxitini ata të identifikojnë stereotipat në listë. Nxitini të mbeten të vëmendshëm ndaj sjelljeve stereotipe (në shtëpi, me miqtë, në shkollë, kur shikojnë video në internet, TV, në mediat sociale dhe kur lexojnë libra shkollorë) dhe të ndajnë njohuritë në klasë (Janeckova *et al.*, 2021, 42-43).

Shënim: Disa burime shtesë të dobishme mund të gjenden në [Mësimdhënia rreth pabarazisë gjinore](#) (Educators 4SC, Mësimdhënia rreth pabarazisë gjinore).

Shembujt e mëposhtëm janë huazuar nga platforma Let Toys Be Toys dhe janë përshtatur me kontekstin lokal. Ata janë të ndarë në grupmosha të ndryshme dhe japin sugjerime se si të integrohen në çështje të ndryshme. Këta shembuj synojnë fëmijët nga **klasat 3 dhe 4**.

● Shembulli 1:

Kërkojuni nxënësve të përshkruajnë në një copë letre lodrën e preferuar dhe pastaj ta palosin atë letër dhe ta fusin në një kuti të përbashkët. Më pas mësimdhënësi do të marrë secilën nga letrat, do të identifikojë nxënësin dhe do ta pyesë pse i pëlqen lodra e caktuar. Mësimdhënësit mund të përdorin një tabelë për të krahasuar rezultatet dhe për të kërkuar tema të përbashkëta midis përgjigjeve nga djemtë dhe vajzat.

Pasi të bëhet kjo, mësimdhënësi do t’ia paraqesë klasës një shumësi lodrash, p.sh., kukulla, makina, lodra rozë, lojëra tavoline ose ndonjë lodër tjetër të preferuar. Për çdo lodër, mësimdhënësi do të pyesë klasën “Për kë është kjo lodër?” dhe shikoni nëse ata e lidhin lodrën me një gjini të caktuar. Mësimdhënësi do të pyesë pse ata besojnë se është ‘lodër e vajzës’ ose ‘lodër e djalit’. Diskutoni këtë me nxënësit duke marrë parasysh mësimet për të menduarit kritik.

● Shembulli 2:

Mësimdhënësi do t'i tregojë klasës një video mbi stereotipat e lodrave (mund të gjeni shumë prej tyre në YouTube).

Shembujt e mëposhtëm janë huazuar dhe përshtatur për këtë Udhëzues ([Equaliteach](#), pa datë, 77-78). Ata synojnë të inkurajojnë diskutimet me fëmijët në klasat **5 dhe 6**, për çështje si ndikimi i stereotipave, stereotipat në media, pëlqimi dhe kufijtë. Si të tilla, këto ushtrime mund të përfshihen në klasat e edukimit qytetar, artit e dizajnit dhe të ngjashme.

● Shembulli 1:

Mësimdhënësi prezanton, ndoshta duke përdorur një PowerPoint me binjakë (një djalë dhe një vajzë) që ndajnë të njëjtën pikënisje në jetë, me të njëjtën familje, të njëjtën shtëpi dhe të njëjtin edukim. Dallimi kryesor është seksi i tyre dhe mënyra se si stereotipat gjinorë i japin formë të ardhmes së tyre.

Aktiviteti:

Ndajeni klasën në grupe të vogla.

Jepini secilit grup katër “Karta statistikore”.

Grupet shpenzojnë pesë minuta duke shqyrtuar statistikën dhe duke diskutuar se si gjinia ose faktorë të tjerë të identitetit mund të formojnë interesat dhe karrierën e ardhshme të binjakëve të tyre.

Pastaj, secili grup ndan një statistikë dhe konkluzionet e tyre se si lodrat e ndryshme, aktivitetet dhe ekspozimi mediatik ndikojnë te binjakët. Mësimdhënësi mbledh këto ide dhe nxit mendim më të thellë duke pyetur:

- Çka i bën njerëzit të mendojnë se disa tema janë vetëm për djem ose vajza?
- Si ndikojnë stereotipat mbi të qenit ‘i dobët’ ose ‘i fortë’ në pikëpamjen e njerëzve për vetveten dhe të tjerët?

Shembull i kartave statistikore dhe pyetjeve:

● Karta 1:

Statistika: 60% e djemve preferojnë futbollin, 50% e vajzave preferojnë kërcimin. Megjithatë, 40% e vajzave pëlqejnë të luajnë sporte si futboli dhe basketbolli.

Pyetje:

- Pse mendoni se djemtë thonë se u pëlqen futboli dhe më shumë vajza thonë se u pëlqen kërcimi?
- A mund të shijojnë djemtë dhe vajzat si sportin ashtu edhe kërcimin? Pse?
- Si mund të ndikojë kjo se në ç’fushë mendojnë binjakët se janë të mirë?

● Karta 2:

Statistika: 65% e djemve duan të jenë inxhinierë/ndërtues; 70% e vajzave duan të jenë mësuese ose infermiere.

Pyetje:

- Pse ky dallim?
- A mund të zgjedhë dikush ndonjë karrierë? Si ndikon loja me lodra të caktuara në këto zgjedhje?

Karta 3:

Statistika: Hulumtimet tregojnë se në emisionet televizive për fëmijë, 75% e personazheve kryesore janë djem, ndërsa vetëm 25% janë vajza. Personazhet e djemve shpesh shfaqen si aventurierë, ndërsa personazhet e vajzave shpesh tregohen si të kujdesshme.

Pyetje:

- Pse mendoni se më shumë personazhe kryesore në shfaqjet për fëmijë janë djem?
- A mund të jenë vajzat aventureske dhe djemtë të kujdesshëm?
- Si mund të ndikojë të shikuarit e këtyre lloj personazheve në mënyrën se si binjakët mendojnë se do të duheshin të vepronin?

Karta 4:

Statistika: Në një anketë për reklamat e lodrave, 90% e reklamave për makina dhe figura aksioni përfshinin djem, ndërsa 85% e reklamave për kukulla dhe komplete kuzhine shfaqnin vajza.

Pyetje:

- Pse mendoni se kompanitë e lodrave reklamojnë disa lodra për djemtë dhe të tjera për vajzat?
- A mendoni se djemtë dhe vajzat mund të kënaqen duke luajtur të dy me makina dhe kukulla?
- Si mund të ndikojnë këto reklama te lodrat me të cilat “pritet” të luajnë binjakët?

● Shembulli 2:

Aktiviteti:

Renditni nxënësit në dy rreshta përballë njëri-tjetrit. Një rresht pyet “A mund të bëj një hap përpara” para se të afrohen. Ata mund të shkelin vetëm nëse personi tjetër përpara thotë “po”. Nëse partneri është i pakëndshëm, ata thonë “jo” dhe hapi ndalet.

Pëlqimi mund të jepet verbalisht ose joverbalisht gjatë këtij ushtrimi. Ushtrimi do të vazhdojë derisa të ndalojnë të gjitha çiftet.

Më pas mësuesi do të bëjë pyetjet e mëposhtme dhe do t’i diskutojë me klasën:

Pse njerëz të ndryshëm ndaluan në distanca të ndryshme? (Të gjithë kanë nivele të ndryshme rehatie).

Si u ndjeve që mund të thuash ‘ndal’ dhe të respektohesh? Si ndihesh kur njerëzit nuk respektojnë kufijtë e tu?

Si do të ndihesh nëse personi do të vazhdonte hapin para pasi t’i thoshe të ndalojë?

Cilat ishin disa mënyra se si u komunikua pëlqimi? A ishte gjithmonë verbal?

Ushtrimi i mëposhtëm është huazuar dhe përshtatur për qëllimet e këtij Udhëzuesi (Mësimi për Drejtësi, pa datë, Bibi: Mësimi 2). Ai është i përshtatshëm për fëmijët në klasat 6-9 dhe mëson konceptin e diskriminimit të ndërlidhur. Ai nxit diskutim në klasë mbi mënyrën se si ndërthuren identitetet tona të ndryshme dhe ndikojnë njëri-tjetrin.

● Shembull:

Hapat e aktivitetit:

- Tregoju nxënësve videon në YouTube mbi diskriminim e ndërlidhur (shikoni [“Intersectionality 101”](#). Nga minuta 1:02 ka shembuj të diskriminimit të ndërlidhur). Siguroni fletë për mbajtjen e shënimeve nëse është e nevojshme dhe riluajeni videon sipas nevojës. Shpjegoni diskriminimin e ndërlidhur – se si faktorë të shumtë të identifikimit (p.sh., gjinia, raca, klasa) kombinohen për të krijuar përvoja unike të privilegjit dhe të marginalizimit.
- Identifikoni një personazh ose skenar nga videoja që tregon diskriminimin e ndërlidhur dhe diskutoni se si identitete të ndryshme ndërveprojnë për t’i formuar përvojat e tyre.
- Kërkojuni nxënësve të tregojnë shembuj të privilegjeve dhe shtypjeve që vunë re. Renditini ato në një tabelë me dy kolona me “Privilegjet” në njërën anë dhe “Shtypjet” në tjetrën.

Lehtësoni diskutimet me këto pyetje:

- Pse është e rëndësishme të merret parasysh diskriminimi i ndërlidhur kur diskutohet për identitetin?
- A ka shembuj të diskriminimit të ndërlidhur në videon që mund të mos jenë të dukshme menjëherë?
- Si ndërthuren dhe e ndikojnë njëri-tjetrin identitetet tona të ndryshme? ([Të mësuarit për drejtësi \(pa datë\) Bibi Mësimi 2: Diskriminimi i ndërlidhur në “Bibi”](#)).

Të gjitha këto ushtrime mund të kombinohen dhe të përshtaten me grupmoshat e përshtatshme dhe mund të shërbejnë si frymëzim për mësimdhënësit/stafin arsimor për t’i zhvilluar materialet dhe burimet e tyre mësimore.

Promovimi i respektit dhe zgjidhjes së konflikteve pa dhunë

Konfliktet janë të pranishme në shkolla anembanë botës, duke përfshirë edhe Kosovën ku ngacmimi dhe frikësimi krijojnë shqetësim dhe pasiguri.

Për ta adresuar këtë, Drejtoria e Arsimit e Prishtinës dhe MASHTI kanë zbatuar trajnimin e mësimitdhënësve, grupet e ndërmjetësimit, forumin “Rritemi së bashku” dhe kanë miratuar Planin e Veprimit për Sigurinë në Shkolla (2023-2026) për t’i adresuar konfliktet në shkolla (Telegrafi, 2023; UNICEF, 2024).

Më poshtë janë disa shembuj të frymëzuar nga UNESCO për promovimin e respektit dhe zgjidhjes së padhunshme të konflikteve midis nxënësve (UNESCO, pa datë, Praktikat më të mira, 13-14).

● Shembulli 1:

Nëse ka një konflikt të vazhdueshëm, ndani nxënësit në dy grupe në anë të kundërta të një konflikti. Secili grup ndan pikëpamjen e tij, ndërsa mësimitdhënësi identifikon interesat e përbashkët dhe ndihmon në krijimin e një kompromisi. Kjo inkurajon mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

Shembulli 2:

Kërkoni nga nxënësit të interpretojnë një skenar për zgjidhjen e konfliktit, si p.sh. dy fëmijë që nuk pajtohen gjatë një loje, për të praktikuar bashkëpunimin dhe respektin. Në rast angazhimi të vogël ose ndërprerjesh, formoni një “Rreth dëgjimi” ku flet vetëm një person që mban një objekt. Ky aktivitet nxit vëmendjen dhe ndjeshmërinë.

Më poshtë janë disa shembuj ushtrimesh që mësimitdhënësit t’i përdorin në mësimin e fëmijëve për zgjidhjen e konflikteve. Këto përfshijnë ndërmjetësimin si një metodë e zakonshme në shkolla ([Qendra për zgjidhje paqësore, pa datë, Ndërmjetësimi në shkolla](#)) (shih listën e referencave) dhe disa ide të dobishme mësimore për të eksploruar kuptimin e konfliktit dhe të situatave të ndryshme të konfliktit.

● Shembulli 1:

Paraqitni një skenar ku dy nxënës nuk pajtohen gjatë një loje. Për shembull:

- A: “Pse nuk ma kalove topin?”
- B: “Trajneri më tha të gjuaja”.

Dy nxënës luajnë me role këtë skenar, duke shtuar emocione në përgjigjet e tyre. Mësimdhënësi ndërmjetëson një diskutim duke përdorur pyetje udhëzuese si:

- Çka e shkaktoi konfliktin?
- Si u ndje secili person?
- Si mund të zgjidhej pozitivisht konflikti?

Vazhdoni t’u tregoni nxënësve fotografi që përshkruajnë lloje të ndryshme konflikti (p.sh., shokët e klasës duke u grindur). Diskutoni:

- Çka po ndodh në imazh?
- Si mund të përshkallëzohet ky konflikt ose të zgjidhet në mënyrë paqësore?
- Keni përjetuar diçka të ngjashme?

Inkurajoni nxënësit të reflektojnë mbi konfliktin si pjesë e natyrshme e jetës dhe të diskutojnë strategjitë për zgjidhje jo të dhunshme (Fairfax Country Schools Public, pa datë, 10 Mësime për Zhvillimin e Shkathtësive për Zgjidhjen e Konflikteve; [Carolina K-12, pa datë, Fotografi e konfliktit](#)) (shih listën e referencave)

Shembulli 2:

Paraqitni një skenar në klasë:

Skenari A: Dy nxënës debatojnë për ndarjen e një tavoline, gjë që i çon në sharje dhe hedhje të sendeve. Mësimdhënësi ndërhyr herët, ndërmjetëson dhe nxit bashkëpunimin.

Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve se si ndërhyrja e hershme mund të parandalojë përshkallëzimin. Si mund të kultivohet puna ekipore dhe empatia?

Skenari B (Reflektimi i mësimdhënësve): Dy anëtarë të stafit nuk arrijnë të bashkëpunojnë, duke ndikuar në planprogram dhe duke krijuar tension. Ndërmjetësimi përdoret për ta zgjidhur konfliktin e tyre.

Merrni parasysh se si mosmarrëveshjet e personelit ndikojnë në mjedisin e shkollës.

Skenari C (Reflektimi i shkollës): Një nxënës raporton se ngacmohet nga një nxënës tjetër. Pasi shkëmbejnë fjalë të rënda, të dy nxënësit ndëshkohen. Shkolla organizon ndërmjetësim për prindërit dhe nxënësit.

Reflektoni nëse përgjigjja ishte e drejtë, për efektivitetin e pezullimit dhe rolet e prindërve.

Mësimdhënësit mund të përdorin ndërmjetësimin për ta parandaluar përshkallëzimin, për të përforcuar kodin e sjelljes, e të aftësohen në shpërshkallëzim dhe në përfshirjen për të ndërtuar një kulturë pozitive. Ndërmjetësimi i kolegëve është mjet efektiv për t'i ndihmuar nxënësit.

Masat proaktive si ndërmjetësimi, parandalojnë përshkallëzimin e konfliktit (Pollack, 2024). Përdorimi i vazhdueshëm i kodit të sjelljes së shkollës dhe ndërhyrja e hershme në konflikte, veçanërisht te ngacmimi, janë thelbësore. Të dëgjuarit aktiv, komentet dhe teknikat qetësuese si frymëmarrja e thellë ndihmojnë në menaxhimin e mosmarrëveshjeve ([Arsimi Gjithëpërfshirës 2023](#)) (shih listën e referencave). Ndërmjetësimi i kolegëve dhe trajnimi i rregullt i personelit në shpërshkallëzim, mbështesin një mjedis pozitiv në shkollë.

Teknikat e integritetit personal

Të mësuarit e nxënësve për integritetin përfshin ndërtimin e respektit për veten, njohjen e kufijve personalë dhe të mësuarit rreth marrjes e dhënies së pëlqimit në mënyra të përshtatshme për moshën. Për nxënësit e moshës 8-12 vjeç, fokusi është të mësojnë ta respektojnë veten dhe të tjerët, të shprehin rehat kur nuk duan të marrin pjesë në një aktivitet dhe të kuptojnë kur të tjerët bëjnë të njëjtën gjë. Në këtë fazë, theksi vihet te shembujt e përditshëm të pëlqimit dhe respektit para se në kontekstet seksuale. Teknikat praktike mund të ndihmojnë në integrimin e këtyre vlerave për nxënësit e moshës 8-12 vjeç ([IPPF, pa datë, Udhëzues për Edukatorë](#)).

- **Shembull:** Nxënësit qëndrojnë në një rreth (ose të vizatuar ose përdorin një rreth fitnesi hula) për të ndjerë konceptin e hapësirës personale. Mësimdhënësi prezanton lloje të ndryshme marrëdhëniesh, si familja, miqtë dhe njerëzit që ata i njohin më pak, dhe i udhëzon t'i vendosin njerëzit nga këto grupe në rrathë koncentrikë që përfaqësojnë nivelin e afërsisë. Duke hartëzuar këto marrëdhënie, nxënësit mësojnë se secili ka kufij personalë që ndryshojnë në varësi të familjaritetit dhe lidhjes së tyre. Ky ushtrim i ndihmon nxënësit të kuptojnë se respektimi i hapësirës personale dhe i kufijve është aspekt kyç i integritetit, duke nxitur një mjedis ku nxënësit njohin dhe respektojnë kufijtë e vet dhe të të tjerëve (IPPF, pa datë, Udhëzues për Edukatorë).

Teknika të tjera të dobishme lidhur me integritetin personal mund të eksploroehen në shembullin e mëposhtëm:

- **Shembull:** Filloni duke shkruar “integritet” në tabelë dhe kërkojuni nxënësve të ndahen në çifte për t’i krijuar përkufizimet e tyre. Ndani dhe përpiloni këto përkufizime si një klasë. Mandej, ndani me ta një histori personale që ilustron integritetin, si p.sh. raportimin e një shoku që kopjoi në test. Paraqitni katër skenarë të shkurtër dhe kërkojuni nxënësve të tregojnë me gishtin e madh (pëlqejnë) *lart* nëse demonstron integritet ose *poshtë* nëse jo, duke e pasuar secilin rast me nga një diskutim të shkurtër. Ndajeni klasën në grupe të vogla dhe jepini secilit grup nga një fletë pune dhe skenarin “Gjëja e duhur për të bërë”, pastaj kërkojuni të diskutojnë dhe të vendosin për mënyrën më të mirë të veprimit. Nxitini grupet t’i luajnë me role skenarët, përpara se t’i paraqesin zgjidhjet në klasë. Përfundoni me një diskutim se përse është i rëndësishëm integriteti dhe si mund ta demonstron nxënësit në jetën e tyre të përditshme.

Të mësuarit e fëmijëve për kufijtë personale dhe pëlqimin shkon paralelisht me të bërit e tyre të ndihen të sigurt dhe të krijojnë imazh pozitiv për veten.

- **Shembull:** Nxënësit mësojnë fuqinë e komplimenteve duke plotësuar fletëpalosjet me fjalë të mira për shokët/shoqet e klasës dhe duke formuar një ‘zinxhir komplimentesh’ nëpërmjet lidhjes së fjalive. Pas kësaj, ata komplimentojnë veten duke renditur pesë gjëra në të cilat janë të mirë ose u pëlqejnë, për ta rritur vetëvlerësimin ([Shëndeti i fëmijëve në klasë](#)).

Adresimi i dhunës ndaj grave dhe i dhunës në familje në klasë

Ky Udhëzues thekson rëndësinë e një qasjeje gjithëpërfshirëse në arsim për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Mësimdhënësit duhet të jenë vigjilentë ndaj shenjave të dhunës, si lëndimet e pashpjegueshme ose ndryshimet e sjelljes, dhe të përgjigjen me ndjeshmëri ndaj zbulimeve të informatave, duke ndjekur protokollet e shkollës dhe duke raportuar tek autoritetet (Shih Modulin 5). Bashkëpunimi mes mësimdhënësve, prindërve, personelit dhe komunitetit siguron mbështetje gjithëpërfshirëse. Konventa e Stambollit thekson materialet edukative të përshtatshme për moshën, si videot dhe lojërat me role për t’i mësuar nxënësit të njohin dhe ta sfidojnë dhunën në mënyrë efektive. Shembulli i mëposhtëm është huazuar nga [Aktivitetet dhe planet mësimore](#) (Equaliteach, Aktivitetet dhe Planet Mësimore. Dhuna në shkollë, shikoni listën e referencave).

- **Shembulli 1:** Shqyrtoni shkurtimisht dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje dhe kërkojuni nxënësve të ndajnë shembuj mediatikë nga detyrat e shtëpisë. Ndajeni klasën në dy grupe: “njerëzit” dhe “gjërat”.

“Njerëzit” mund të mendojnë, të ndjejnë dhe të marrin vendime. Ata japin urdhra.

“Gjërat” nuk mund të mendojnë, të ndjejnë a të vendosin. Ato duhet të ndjekin urdhrat dhe të kërkojnë leje.

“Njerëzit” kanë 2-3 minuta për t’u dhënë “Gjërave” detyra të thjeshta, të respektueshme (pa veprime agresive ose degraduese). Pastaj ndërrojnë rolet.

Pas të dyja turneve, diskutoni:

Si u ndje secili rol?

A keni vënë re mosbalancime të pushtetit ose dhunë?

A i trajtojmë ndonjëherë të tjerët si “gjëra” në jetën reale?

Si mund të sigurohemi që të gjithë të trajtohen me respekt dhe pa dhunë ndaj grave/dhunë në familje?

Shembulli tjetër është huazuar nga [Manuali: Program trajnimi për dhunën me bazë gjinore](#) (Komisioni Evropian, 2020, 24).

● **Shembull:**

Mësimdhënësi do t’u shpjegojë nxënësve ç’do të thotë dhunë ndaj grave/dhunë në familje dhe për format e dhunës, të cilat nuk janë vetëm fizike, por mund të jenë edhe emocionale dhe psikologjike, si kontrolli, kërcënimi, izolimi etj. Për të përfshirë një mendim kritik midis fëmijëve, mësimdhënësi do të listojë disa shembuj të ‘shenjave të marrëdhënieve jo të shëndetshme’ si këta - Ai/Ajo:

Të poshtëron dhe të bën të ndihesh keq

- Të kontrollojë vazhdimisht (ku je, me kë je dhe çka po bën)
- Të bën të mos ndihesh rehat për të bërë atë që dëshiron
- Të akuzon pa të drejtë
- Është jashtëzakonisht xheloz/e
- Beson se ka më shumë të drejta se ti.
- Kërkon fjalëkalimet e tua (media sociale, email, telefon).

- Të detyron të bësh gjëra që nuk dëshiron.
- Të tall para miqve.

Rregulloni listën e shenjave sipas nevojës për grupmoshën. Kërkojuni nxënësve të shqyrtojnë shenjat dhe të komentojnë, duke shënuar përgjigjet në tabelë.

Shpjegoni se dhuna me bazë gjinore mund të ndodhë kudo e në çdo kohë, dhe se injorimi i saj mund të sinjalizojë që sjellja nuk është e gabuar. Kujtojuni nxënësve se heshtja mund t'i bëjë ata bashkëfajtorë.

Ndajini nxënësit në grupe me nga 4 persona dhe kërkojuni të reflektojnë për rreth 15 minuta lidhur me:

Një herë kur panë dikë të lënduar apo trajtuar padrejtësisht.

Një herë kur ata morën pjesë në lëndimin nga trajtimi i padrejtë i dikujt tjetër.

Një herë kur panë dikë të lënduar ose trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe askush nuk ndërhyri.

Një herë kur panë dikë të ndërhynte.

Më pas, diskutoni si klasë e tërë, duke renditur në tabelë shembuj të ndryshëm të dëmtimit ose trajtimit të padrejtë si një formë dhune.

MODULI 5:

Zbulimi i informacioneve për identifikimin dhe reagimin

Ky Modul fokusohet në identifikimin dhe reagimin ndaj zbulimit të informacioneve dhe prandaj është krijuar për t'u zbatuar nga i gjithë personeli. Ai ofron udhëzime të përshtatura për rolet e tyre duke bërë dallimin midis përgjegjësive specifike të pozicioneve të ndryshme brenda mjedisit arsimor. Lexuesit mund t'i referohen Modullit 2 për përshkrime dhe përkufizime të hollësishme gjatë përdorimit të këtij Moduli për strategji praktike të reagimit.

Njohja e shenjave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje


Njohja e hershme e shenjave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është thelbësore, pasi këto mund të jenë:

- **Fizike**, si lëndimet e pashpjegueshme.
- **Psikologjike**, si ankthi dhe tërheqja.
- **Të sjelljes**, si mungesat e shpeshta, sjellja agresive, sukseset e mëdha në shkollë, qëndrimi vonë në shkollë, të shfaqurit si tepër punëtore (Platforma Evropiane e Trajnimit për Dhunën në Familje, 2024, Treguesit e dhunës në familje) (Udhëzues i Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, 2021).

Mësimdhënësit dhe personeli i shkollës duhet të përgjigjen me ndjeshmëri gjinore, të krijojnë një mjedis besimi, të shmangin gjykimin dhe të sigurojnë konfidencialitet duke ndjekur protokollin e shkollës dhe duke ofruar mbështetje të vazhdueshme. Është e rëndësishme të theksohet se shenjat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje mund të mos përputhen gjithmonë me treguesit tipikë. Për shkak se mësimdhënësit janë më afër nxënësve, ata duhet të jenë të vetëdijshëm se fëmijët që përjetojnë dhunë në familje mund të shfaqin sjellje të ndryshme, si p.sh. të tregojnë shumë sukses, të qëndrojnë vonë në shkollë ose të duken tejet punëtore, në vend se të shfaqin shenja më të dukshme. Të dish se si të pyesësh me ndjeshmëri për shqetësimet është thelbësore për identifikimin dhe mbështetjen efektive të këtyre nxënësve.

Qasja në mbështetje

Shërbimet mbështetëse të viktimave, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit, përfshijnë strehimore, linja telefonike, shërbime të dhunës seksuale, shërbime të mbështetjes ligjore, qendra këshillimi dhe mbështetje për fëmijë dëshmitarë. Kosova ka në funksion mekanizmat dhe shërbimet mbështetëse qeveritare dhe joqeveritare në vijim:



Kosova ka zhvilluar edhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) si protokolle ndërsektoriale për bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve të tjera të përfshira në përkrahjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (Këshilli i Evropës, 2022, 8). Këto PSV detajojnë hapat për identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës, vlerësimin e rreziqeve, referimin e viktimave te shërbimet mbështetëse dhe trajtimin e autorëve të dhunës.

Sistemet dhe burimet mbështetëse për nxënësit e prekur

Shkollat duhet të ofrojnë mjedise të sigurta dhe mbështetëse për nxënësit e prekur nga dhuna. Kjo përfshin profesionistë të trajnuar, mekanizma të brendshëm mbështetës, si dhe lidhje me shërbime të jashtme. Shkollat priten të kenë:

- Psikologë të trajnuar për kujdesin e ndjeshëm ndaj traumës.
- Udhëheqësi mbrojtës dhe ekupe të përkushtuara për siguri dhe mirëqenie.
- Kod etike dhe sisteme për raportimin e incidenteve si Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsimit (SMIA).
- Hapësira të sigurta, si një zyrë e caktuar për diskutime konfidenciale.

Mësimdhënësit dhe personeli duhet të jenë në gjendje të njohin shenjat e shqetësimit dhe të ofrojnë mbështetje fillestare. Nëse ndonjë nxënës tregon për abuzim, personeli mund të ndjekë PSV-në e Kosovës - duke ruajtur konfidencialitetin, duke iu referuar shërbimeve të jashtme dhe, në raste emergjente, duke aktivizuar protokollin e krizës dhe shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve.

Mësimdhënësit dhe personeli i shkollës mund të ndihen të pasigurt ose të papërgatitur për të trajtuar situata të tilla, ndërsa ngarkesat e mëdha të punës mund ta bëjnë të vështirë adresimin efektiv të rasteve (Selvik, 2022, f.655). Trajnime të vazhdueshme ndihmojnë në forcimin e vetëbesimit dhe

përditësimin e njohurive. Reagimet e mësuesve ndikojnë ndjeshëm në rezultatin e situatës. Ata duhet të dëgjojnë pa paragjykime e pa ndërprerje, të shmangin supozimet dhe pyetjet e tepërta, dhe të jenë në gjendje të njohin shenjat e mundshme të shqetësimit, frikës ose tërheqjes emocionale.

Para se të diskutojnë hollësi, mësuesit dhe stafi shkollor duhet të përqendrohen në nevojat emocionale të fëmijës, duke përdorur teknika qetësuese. Duhet t'i lejojnë nxënësit ta udhëheqin bisedën përmes pyetjeve të hapura, duke i siguruar se ndjenjat e tyre janë të vlefshme dhe se nuk kanë asnjë faj.

Të gjitha rrëfimet duhet të mbahen konfidenciale dhe të ndiqen procedurat ligjore të shkollës dhe të Kosovës për mbrojtjen e fëmijëve dhe raportimin e abuzimit, siç parashihet në PSV (Procedurat Standarde të Veprimit).

Sistemet dhe burimet mbështetëse për të rriturit e prekur

Edhe të rriturit, si stafi i shkollës dhe prindërit, mund të përjetojnë dhunë dhe të kenë nevojë për mbështetje. Shkollat duhet të jenë në gjendje të ofrojnë këshillim dhe burime konfidenciale për stafin e prekur, dhe stafi të inkurajohet t'i përdorë këto shërbime pa frikë nga stigma ose hakmarrja. Politikat e shkollës pritet të promovojnë një vend pune të sigurt duke zbatuar politika kundër ngacmimit dhe kundër dhunës, si dhe të kenë protokolle për raportimin dhe trajtimin e dhunës në vendin e punës.

Sipas nenit 18 të Konventës së Stambollit, shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave duhet:

- të jenë të rrënjosura në të kuptuarit gjinor,
- të prioritetizohen të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i viktimës, të shmangët viktimizimi dytësor nëpërmjet një kulture besimi, fokusi të jetë në fuqizimin dhe vetëvendosjen, të promovohet pavarësia ekonomike dhe të adresohen nevojat specifike të personave të cenueshëm, duke përfshirë fëmijët viktimë dhe fëmijët dëshmitarë. (Kelly, 2018, 6).

Mbështetja e kolegëve që përjetojnë dhunë ndaj grave/dhunë në familje kërkon dhembshuri dhe ndjeshmëri. Mos i arsyetoni kurrë sjelljet e abuzuesit, pasi kjo minimizon seriozitetin dhe dëmton besimin e viktimës. Njihni kufizimet dhe kurrë mos u përballni drejtpërdrejt me abuzuesin. Respekti zgjedhjet e viktimës dhe pranoni se shqetësimet e sigurisë mund t'i vazhdojnë edhe nëse marrëdhënia përfundon. Mos sugjeroni që viktimë ta ndryshojë sjelljen e vet, pasi kjo përforcon vetëfajësimin. Ofroni mbështetje afatgjatë, përmbahuni nga kritikë dhe respekti autonomi e viktimës (UK Says No More, 2024).

Rolet dhe përgjegjësitë

Çdo rol brenda sistemit shkollor është jetik për mbështetjen e individëve të prekur dhe ruajtjen e një mjedisi të sigurt.

Roli i administratës së shkollës

Administratat e shkollave duhet t'i krijojnë dhe t'i mbikëqyrin strukturat mbështetëse, si dhe të sigurojnë që politikat dhe PSV-të të zbatohen vazhdimisht. Sipas praktikave më të mira, administrata e shkollës mund:

- të krijojë ekipe reagimi dhe të sigurojë që i gjithë stafi të marrë trajnime për njohjen dhe reagimin ndaj dhunës.
- të krijojë protokolle të qarta dhe të qasshme për raportimin dhe adresimin e incidenteve.
- të mbajë një listë të organizatave mbështetëse lokale dhe të sigurojë bashkëpunimin me burimet e jashtme.
- të sigurojë përditësime dhe shqyrtime të rregullta të politikave të shkollës për të siguruar përafrimin me PSV-të (Udhëzues i Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, 2021, 13-14).

Roli i udhëheqjes për mbrojtje/ruajtje të fëmijëve

Në përputhje me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, të miratuar nga MASHTI në vitin 2023, çdo institucion arsimor është i obliguar të caktojë një Pikë Kontakti për mbrojtjen e fëmijës, e cila ka rol kyç në zbatimin e politikës institucionale për mbrojtjen e fëmijëve dhe krijimin e një mjedisi të sigurt e mbështetës për të gjithë nxënësit. Politika ka për qëllim të parandalojë dhe të adresojë çdo formë të dhunës, abuzimit, neglizhimit ose shkeljes së të drejtave të fëmijëve në institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar.

Pika e Kontaktit udhëzon dhe mbështet zbatimin e politikës dhe të procedurave të mbrojtjes së fëmijës brenda institucionit, përmes këtyre detyrave kryesore:

- Ofron udhëzime lidhur me zbatimin e politikës dhe çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijës;
- Reagon ndaj shkeljeve të politikës dhe shqetësimeve që vijnë nga fëmijët;
- Informon fëmijët në mënyrë të kuptueshme për të drejtat dhe mbrojtjen që u takon;
- Mbështet identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që mund t'u kanosen fëmijëve;
- Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët dhe autoritetet përkatëse për menaxhimin e rasteve;
- Ofron trajnime dhe mbështetje për stafin arsimor dhe ndihmës;
- Mban shënime dhe raporton rastet në përputhje me SMIA;
- Monitoron zbatimin e politikës në institucion dhe promovon vetëdijësimin për të.

Ndërkohë, përgjegjësia kryesore për menaxhimin dhe referimin e rasteve i takon udhëheqësisë së shkollës. Pika e kontaktit është mbështetëse dhe orientuese për zbatim efikas të politikës dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate në përputhje me nevojat dhe interesin më të mirë të fëmijës (MASHTI, 2023).

I tërë stafi: Konfidencialiteti dhe ndjeshmëria në trajtimin e informatave të zbuluara

Konventa e Stambollit thekson rëndësinë e konfidencialitetit në mbrojtjen e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konfidencialiteti mbron privatësinë, sigurinë dhe dinjitetin e viktimave, duke siguruar që çdo informacion i ndarë të mbetet i sigurt dhe i qasshëm vetëm për personat e autorizuar që janë drejtpërdrejt të përfshirë në ofrimin e mbështetjes (Neni 28; Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm, 2021). Viktimat duhet të kenë besim se të dhënat e tyre personale nuk do të shpërndahen pa nevojë, pasi zbulimet e paautorizuara mund t'i dekurajojnë të kërkojnë ndihmë, t'i bëjnë më të cenueshme ose t'i ekspozojnë ndaj hakmarrjes. Sipas këtyre udhëzimeve, çdo raportim nga dëshmitarët ose profesionistët duhet të trajtohet me diskrecion maksimal. Konventa e Stambollit përcakton qartë rrethanat në të cilat profesionistët mund të raportojnë raste, pa shkelur detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit. Prandaj, shkollat duhet të miratojnë protokolle të rrepta konfidencialiteti, të cilat kufizojnë ndarjen e informacionit vetëm mbi parimin “duhet ta di” (need-to-know) (Neni 28). Kjo qasje nxit viktimat të paraqiten me guxim, të sigurt se përvojat e tyre do të trajtohen me përgjegjësi dhe ndihmon në krijimin e një mjedisi ku nxënësit ndihen të sigurt kur ndajnë informacione të ndjeshme.

Bashkëpunimi me prindërit, kujdestarët dhe shërbimet e jashtme mbështetëse

Mbështetja efektive kërkon bashkëpunim me familjet dhe sistemet e jashtme të mbështetjes. Shkollat pritët të punojnë me prindërit dhe kujdestarët, duke mbajtur komunikim të hapur për politikat dhe protokollat. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit dhe nxit familjet të raportojnë çdo shqetësim rreth dhunës që ua prek fëmijët. Shkollat pritët të kenë të krijuara edhe partneritete me shërbimet mbështetëse lokale, duke përfshirë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, ofruesit e shëndetit mendor, si dhe shërbimet e ndihmës juridike falas.

Veprimet e menjëhershme në rast të zbulimit të informatave

Shkollat, shpesh linja e parë e mbrojtjes, luajnë rol kyç në identifikimin e shenjave të dhunës dhe atyre u kërkohet t'i raportojnë rastet e dyshuara tek autoritetet duke përdorur formularët e referimit.

Imagjinoni skenarët në vijim:

Hana është tërhequr së fundmi, duke humbur disa ditë mësimi pa asnjë shpjegim. Mësimdhënësi vëren mavijosje në kyçet e Hanës dhe një pamje të vazhdueshme ankthi. Gjatë një bisede private për mungesat e saj, Hana i tregon se babai i ka keqtrajtuar fizikisht dhe verbalisht atë dhe të ëmën në shtëpi. Kjo situatë përfshin qartazi Dhunë në Familje dhe Dhunë në Bazë Gjinore dhe kërkon veprim të menjëhershëm e të koordinuar për t'i mbrojtur Hanën dhe nënën e saj, si dhe për ta mbajtur përgjegjës autorin e dhunës.

Më poshtë është një listë e veprimeve të menjëhershme që duhet të ndërmerren nga stafi i shkollës në rast të zbulimit të informacionit për Dhunë në Familje dhe Dhunë në Bazë Gjinore. Këta hapa bazohen në PSV-të aktuale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, të përshtatura për mjedisin shkollor.

1. QËNDRONI TË QETË DHE OFRONI HAPËSIRË TË SIGURT

- Nëse Hana shpalos informata për abuzim ose dhunë, qëndroni të qetë. Reagimi juaj mund të ndikojë shumë në sa e sigurt ndihet ajo.
- Zgjidhni një mjedis të qetë, privat ku nxënësi mund të flasë lirshëm, larg nxënësve të tjerë ose personelit që nuk ka nevojë të përfshihet.

2. DËGJONI AKTIVISHT DHE SIGUROHUNI

Mos shprehni tronditje ose mosmiratim. Le të flasë Hana me ritmin e saj.

- Përdorni fraza qetësuese: “Unë të besoj”, “Nuk është faji yt”, “Bëre gjënë e duhur që i the dikujt”.
- **Mos** premtoni konfidencialitet absolut; shpjegoni detyrimin tuaj për të kërkuar ndihmë nëse është e nevojshme.

3. MBLIDHNI INFORMATAT THEMELORE (ME NDJESHMËRI)

- Bëni pyetje të thjeshta dhe të hapura për të sqaruar çka ka ndodhur:
 - “A mund të më thuash më shumë se çka ka ndodhur?”
 - “A ndihesh e sigurt në shtëpi ose këtu në shkollë?”
- Merrni shënime të shkurtra faktike (data, ora, shenjat e dukshme të lëndimit, fjalët e vetë nxënësit). Roli juaj NUK është të hetoni, por të ofroni sigurinë e nxënësit.

4. VLERËSONI RREZIKUN E MENJËHERSHËM

- Nëse Hana është në rrezik të menjëhershëm ose ka shqetësim të rëndë, urgjentisht telefononi Policinë e Kosovës (192).
- Nëse ka lëndime që kërkojnë trajtim urgjent, përfshini profesionistë shëndetësorë dhe ndiqni protokollet e urgjencës të shkollës suaj.

5. RAPORTONI NË PIKËN FOKALE TË PËRCAKTUAR TË SHKOLLËS

- Informoni personin e duhur (p.sh. drejtorin, këshilltarin, psikologun, udhëheqësin mbrojtës).
- Ndani çdo shënim ose njohuri në lidhje me shpalosjen e informatave në mënyrë që ata të kenë njohuri të qartë të situatës.

6. REFERONI TEK AUTORITETET DHE SHËRBIMET E JASHTME

- Kontaktoni Qendrën për Punë Sociale (QPS) sipas PSV-ve.
- Informoni Policinë e Kosovës nëse nuk e keni kontaktuar tashmë, veçanërisht nëse Hana është në rrezik të menjëhershëm.
- Koordinoni me institucionet e tjera sipas nevojës:
 - Zyra për avokim dhe ndihmë viktimave
 - Strehimoret ose shtëpitë e sigurta
 - Ofruesit e kujdesit shëndetësor
 - OJQ-të lokale

7. DOKUMENTONI VEPRIMET E MARRA

- Mbani një regjistër të qartë të datave, orëve, dhe njerëzve ose institucioneve të kontaktuara.
- Qëndroni në kontakt me agjencitë e referuara për të monitoruar situatën e Hanës dhe për të siguruar mbështetje të vazhdueshme.

8. OFRONI MBËSHTETJE TË VAZHDUESHME

- Sigurohuni që nxënësi të ketë qasje tek një këshilltar ose anëtar i besuar i stafit për kontrolle të rregullta.
- Organizoni ndërrimin e klasës ose vendit ku ulet, ose masa të tjera mbrojtëse nëse është e nevojshme.
- Aty ku është e sigurt, përfshini prindërit/kujdestarët joabuzues në bashkëpunim me QPS-në dhe institucionet e tjera përkatëse.

9. RESPEKTONI KONFIDENCIALITETIN DHE ETIKEN PROFESIONALE

- Ndani hollësitë vetëm me ata që e trajtojnë drejtpërdrejt rastin.
- Përbushni obligimet e detyrueshme të raportimit në mënyrë të përgjegjshme dhe etike sipas ligjit të Kosovës dhe PSV-ve.

Këto veprime të menjëhershme bazohen në PSV-të ekzistuese. Pasi të miratohen PSV-të e reja, ky seksion do të përditësohet për të pasqyruar çdo ndryshim në procedura. Qëllimi kryesor është të sigurohet që çdo shpalosje e informatave të adresohet me shpejtësi, në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme, duke i dhënë gjithmonë përparësi mirëqenies dhe mbrojtjes së nxënësit.

Për detaje shtesë dhe udhëzime të mëtejshme, ju lutemi konsultohuni me [Udhëzuesin për informim të publikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit](#).

Bibliografia

- Lëvizje për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore, 16 ditë aktivizëm. (2023). Lëvizje për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore, gjendet në: <https://tinyurl.com/dverh4he>, qasja e fundit 21 gusht 2024.
- Agjencia për Barazi Gjinore (pa datë), *Parandalimi i stereotipave gjinorë dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore. Udhëzues Metodologjik (Parandalimi i stereotipave gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore)*, hartuar me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze, gjendet në: <https://tinyurl.com/53z3dkvs>.
- AWARE (pa datë), *Udhëzues mësimdhënës për ndjeshmërinë gjinore në klasë. Parandalimi dhe reagimi ndaj paragjykimeve dhe bullizmit*, 5, gjendet në: <https://tinyurl.com/3mdhjh4h>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- Banjska I., Ryan, David J.J., Farnsworth N., Demiri L., Sijarina L., Tershani A. (2019), *Diskriminimi me Bazë Gjinore dhe Punësimi në Kosovë*, Rrjeti i Grave të Kosovës, fq. 47-48.
- Beeden K. (2023), *Njihni këto forma delikate, por jashtëzakonisht reale të abuzimit emocional*. Mediumi, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/4kr8t59x>, qasja e fundit 27 gusht 2024.
- Butler E., dhe Hrytsenko L. (2024), *Një listë kontrolli për parandalimin e dhunës ndaj grave përmes edukimit formal dhe joformal: Neni 14 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje* (Konventa e Stambollit), Këshilli i Evropës, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/4a4sct9t>.
- Carolina K-12. (pa datë), *Një fotografi e konfliktit*, i disponueshëm në internet: <https://shorturl.at/hpsHw>, qasja e fundit 10 shtator 2024.
- Qendra për zgjidhje paqësore (pa datë), *Ndërmjetësimi në shkollë*, i disponueshëm në internet: <https://centreforpeacefulsolutions.org/schools/>, qasja e fundit 10 shtator 2024.
- Chauhan P. dhe Rashmi Mehrotra R. (2022), *Rëndësia e të menduarit kritik në arsim*. Revista Botërore e Gjuhës Angleze, vëll. 12, nr.3.: 126-133. DOI: 10.5430/wjel.v12n3p126.
- Clearinghouse for Sport (2022), *Seksualiteti dhe perspektivat gjinore mbi etikën sportive*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/y5dfk4fr>, qasja e fundit 27 gusht 2024.
- Crenshaw K. (2019), *Hartëzimi i margjinave: Diskriminimi i ndërlidhur, politika e identitetit dhe dhuna ndaj grave me ngjyrë*. Shqyrtimi i Ligjit të Stanfordit. Vëll. 43, nr. 6, fq. 1241-1299. Këshilli i Evropës (2011), *CETS 210- Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje*, 11.V.2011.
- Këshilli i Evropës (2016), Fjalori i Barazisë Gjinore, f.25, i disponueshëm në internet: <https://edoc.coe.int/en/gender-equality/6947-gender-equality-glossary.html>.
- Këshilli i Evropës (2019), *Krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder”*, Fletëpalosje.
- Këshilli i Evropës (2019), *Gjymtimi i organeve gjenitale femërore. I sigurt nga frika i sigurt nga dhuna*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/4hmdyf4k>, qasja e fundit 9 nëntor 2024.
- Këshilli i Evropës (2019), *Përndjekja. I sigurt nga frika i sigurt nga dhuna*, i disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/stalking-eng/pdf/1680b07cfd>, qasja e fundit 9 nëntor 2024.

- Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, pa datë, *Barazia Gjinore*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/bdhv9fxx>, qasja e fundit 20 gusht 2024.
- Platforma Evropiane e Trajnimit për Dhunën në Familje (2024), *Moduli 8: Stereotipat dhe paragjykimet e pavetëdijshme*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/9dz9dwfb>, qasja e fundit 31 gusht 2024.
- Greig A. (2016). Të kuptuarit e maskuliniteteve dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. UN Women, i disponueshëm në internet: https://trainingcentre.unwomen.org/RESOURCES_LIBRARY/Resources_Centre/masculinities%20booklet%20.pdf.
- Hale Sh. (2018), Çfarë po u mësojmë djemve kur i dekurajojmë të lexojnë libra për vajzat? The Washington Post, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/4cbetut6>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- Harvard (2024), Çfarë është zgjidhja e konfliktit dhe si funksionon? i disponueshëm në internet: <https://www.pon.harvard.edu/daily/conflict-resolution/what-is-conflict-resolution-and-how-does-it-work/>, qasja e fundit 10 shtator 2024.
- Fushata për të drejtat e njeriut (pa datë), *Orientimi seksual dhe përkufizimet e identitetit gjinor*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/yc5wmp64>, qasja e fundit 21 gusht 2024.
- Edukimi gjithëpërfshirës (2023), *Strategjitë e zgjidhjes së konflikteve në klasë*, i disponueshëm në internet: <https://rb.gy/zxy8ls>, qasja e fundit 16 shtator 2024.
- Qendra Ndërkombëtare për Fëmijët e Zhdukur dhe të Shfrytëzuar (2021), *Udhëzues i Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve*. i disponueshëm në internet: <https://cdn.icmec.org/wp-content/uploads/2023/10/Comprehensive-Child-Safeguarding-and-Protection-Handbook.docx>.
- Grupi Punues i Kurrikulës Ndërkombëtare të Seksualitetit dhe HIV (2009), *It's All One Curriculum: Aktivitetet për një qasje të unifikuar ndaj edukimit seksual, gjinor, HIV dhe të drejtave të njeriut*, redaktuar nga Nicole Haberland dhe Deborah Rogow, Nju Jork: Këshilli i Popullsisë, f. 76.
- IOP Instituti i Fizikës (2019), *Stereotipat gjinorë dhe efekti i tyre te të rinjtë*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/4c83ufep>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- IPPF (pa datë), *Mësimdhënia rreth pëlqimit dhe kufijve të shëndetshëm – udhëzues për edukatorë*, i disponueshëm në internet: <https://www.studocu.com/row/document/victoria-university-uganda/literatura-v2/teaching-about-consent-healthy-boundaries-a-guide-for-educators/65228102>, qasja e fundit 9 shtator 2024.
- Janečková, H., Tambo S., M. dhe Bivar Black, M. (2021), *Paketa e mjeteve arsimore për të ndihmuar në luftimin e stereotipave gjinore në shkollën fillore – Sfidimi i nxënësve për të zbuluar një botë mundësish bazuar në shembullin e sektorit të transportit*, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, f.14, <https://data.europa.eu/doi/10.2832/27413>.
- Kelly L. (2018), *Shërbime mbështetëse të hartëzimit për viktimat e dhunës ndaj grave në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit. Metodologjia dhe Mjetet*, Këshilli i Evropës.
- Kern V. & Lecerf M. (2023), *Pushimi i lehonisë dhe i atësisë në BE*. Shërbimi i Kërkimit Parlamentar Evropian, i disponueshëm në internet: <https://shorturl.at/juPgj>, qasja e fundit 10 dhjetor 2024.
- Shëndeti i fëmijëve në klasë (2016), *Udhëzues për mësimdhënës*, i disponueshëm në internet: <https://shorturl.at/1MFji>, qasja e fundit 9 shtator 2024.
- Komuna e Prishtinës/Drejtoria e Arsimit (2023), *Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026*, i disponueshëm në internet: https://prishtinaonline.com/uploads/plani_i_veprimit_per_siguri_ne_shkolla_2023-26_dokumenti_narrativ_final.pdf.

- Telegrafi (2023), Prezantohet plani i veprimit për siguri në shkollat e Prishtinës. Në internet: <https://telegrafi.com/en/prezantohet-plani-veprimit-per-siguri-ne-shkollat-e-prishtines/>, qasja e fundit 15 mars 2025.
- Koha (2022), *Drejtoria e Arsimit fillon planin për sigurinë në shkollat e kryeqytetit*, artikulli i lajmeve, i disponueshëm në internet: <https://www.koha.net/arberi/drejtoria-e-arsimit-fillon-planin-per-sigurine-ne-shkollat-e-kryeqytetit> qasja e fundit 16 nëntor 2024.
- Mësimi për Drejtësi (pa datë), 'Bibi' Mësimi 2: Diskriminimi i ndërlidhur në "Bibi", i disponueshëm në internet: <https://www.learningforjustice.org/classroom-resources/lessons/bibi-lesson-2-in-intersectionality-in-bibi-6-8#:~:text=Intersectionality%20acknowledges%20that%20people%20are,and%20oppression%20in%20different%20ways.>, qasja e fundit 4 shtator 2024.
- Let Toys Be Toys (2024), *Ngritja e çështjes së stereotipave në shkollë – rast studimor*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/p89e9a7k>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- Let Toys Be Toys. *Dhjetë mënyra për të sfiduar stereotipat gjinorë* në klasë, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/bdHz7ta8>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- Mackay F. (pa datë), *Rritja e djemve/fëmijëve: Mënyra feministe- Ose: Disa ide për rritjen e fëmijëve pa kufizime gjinore*, i disponueshëm në internet: <https://finnmackay.wordpress.com/articles/raising-boys-the-feminist-way/>, qasja e fundit 3 shtator 2024.
- Maulana B. (2021), *Djemtë nuk qajnë. Patriarkia dhe maskuliniteti toksik*, Blog në Medium, i disponueshëm në internet: <https://medium.com/blueinsight/boys-dont-cry-patriarchy-and-toxic-masculinity-15253b1abc04>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- Meron R.L., Eisma M., Browne K. (2022). Pse femrat viktimat të dhunës në familje mbesin në marrëdhëniet abuzive ose largohen nga to? *Studim cilësor. Revista e Agresionit, Keqtrajtimit dhe Traumës*, 31(5), 677-694, fq 683-687. <http://doi.org/10.1080/10926771.2021.201954>.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2023). *Politika për mbrojtjen e fëmijës në institucionet e arsimit parauniversitar*. <https://masht.rks-gov.net/politika-per-mbrojtjen-e-femijeve-ne-institucionele-e-arsimit-parauniversitar/>.
- Ministria e Arsimit/Qeveria e Kosovës (2022). *Informatori i Shkollës për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë*, në internet: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/informatori-anglisht.pdf>.
- Moleiro C. & Pinto N. (2015), *Orientimi seksual dhe identiteti gjinor: shqyrtimi i koncepteve, polemikave dhe lidhja e tyre me sistemet e klasifikimit psikopatologjik*, *Frontiers in Psychology*, Vëll.6: 1-6, f.1, <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2015.01511>.
- Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Hogan (2021), *Procedura e Opinionit 1/19 e iniciuar pas një kërkesë të bërë nga Parlamenti Evropian (Kërkesë për një opinion sipas nenit 218(11) TFBE-Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (I)* i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/bdcj7u2n>, qasja e fundit 16 nëntor 2024.
- Prindërimi i planifikuar (pa datë), *Cilat janë rolet dhe stereotipat gjinorë*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/mcww4w82>, qasja e fundit 21 gusht 2024.
- Pollack J. (2024), *4 strategji të depërkallëzimit për sfidimin e nxënësve (+ shembuj)*, i disponueshëm në internet: <https://rb.gy/lwhv21>, qasja e fundit 16 shtator 2024.
- QSI Shkolla Ndërkombëtare e Maltës, 2021-2022, *Manual për mbrojtjen dhe mbrojtjen e fëmijëve. Udhëzimet dhe protokollin për nxitjen e një mjedisi të sigurt shkollor për fëmijët dhe të rinjtë*, i disponueshëm në internet: https://resources.finalsite.net/images/v1633011917/qsiorg/edofmcbp3rqpm6zbrojh/MALTAQSIChildProtectionHandbook_1.pdf, qasja e fundit 15 nëntor 2024.

- Pandea A.R., Grzemny D., Kee Ellie. (2019). Çështje gjinore. Manual që trajton dhunën me bazë gjinore që prek të rinjtë. Këshilli i Evropës, f. 24, i disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/gender-matters-a-manual-on-addressing-gender-based-violence-affecting-/16809e1c34>.
- Reeson Education (2024), *Sfidimi i stereotipave gjinore në klasë*, i disponueshëm në internet: <https://shorturl.at/XxWpR>, qasja e fundit 31 gusht 2024.
- Rrjeti i Grave të Kosovës (2020), *RrGK kërkon integrimin e perspektivës gjinore në tekstet e reja shkollore*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/ympf7xyx>, qasja e fundit 28 gusht 2024.
- Selvik S. & Helleve I. (2022), Të kuptuarit e pasigurisë së mësimdhënësit në takimet me nxënësit me përvoja të dhunës në familje. *Revista skandinave e kërkimeve arsimore*. Vëll. 67, lëshimi 4, 650-662. <https://doi.org/10.1080/00313831.2022.2042845>.
- Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (2013), të publikuara nga Agjencia për Barazi Gjinore, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/ydaytdhv>, qasja e fundit 9 gusht 2024.
- Taylor B. (2019), *Diskriminimi i ndërlidhur 101: çka është dhe pse është e rëndësishme?* Womankind Worldwide, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/da3zwyhz>.
- TëVë, MASHTI ndan 3 milionë euro bursa për studentët e universiteteve publike, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/mr7tby8h>, qasja e fundit 14 shtator 2024.
- The Survivors Trust (pa datë), *Edukator i informuar për trauma (TIE) shenjë cilësie*, i disponueshëm në internet: <https://thesurvivorstrust.org/trauma-informed-educator/>, qasja e fundit 16 nëntor 2024.
- MB Says No More (2024), *Reago. Është e rëndësishme të merrni parasysh sa vijon kur të mbështesni mikun, anëtarin e familjes ose kolegun tuaj*, i disponueshëm në internet: <https://rb.gy/6g3x43>, qasja e fundit 18 shtator 2024.
- UNDP (2022), *Global Engineering Girls Kosovo. Përmbledhje e projektit*, i disponueshëm në internet: <https://www.undp.org/kosovo/projects/global-engineer-girls-kosovo>, qasja e fundit 20 gusht 2024.
- UNESCO (pa datë), *Praktikat më të mira të zgjidhjes jo të dhunshme të konflikteve brenda dhe jashtë shkollës: Disa shembuj*, Divizioni për Promovimin e Arsimit Cilësor, fq. 13-14.
- UNICEF (2024), *Grupet e ndërmjetësimit, kundër dhunës në shkollë*, i disponueshëm në internet: <https://shorturl.at/kJNzR>, qasja e fundit 5 shtator 2024.
- Vilhelmssdottir H.B. (2014), *Rëndësia e Arsimit për Barazinë Gjinore, Prezantim gjatë Konferencës "Luftimi i stereotipave gjinore në arsim dhe përmes saj"*, i mbajtur më 9-10 tetor 2014 dhe i organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Ministria e Arsimit dhe Kulturës e Finlandës, e disponueshme në internet: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680687d68>, qasja e fundit 31 gusht 2024.
- Gratë në Sport (2024). *'Djemtë do të jenë djem' - krijimi i një brezi të ri të aleatëve meshkuj për vajzat në sport*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/mrxaaxh3>, qasja e fundit 30 gusht 2024.
- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) (2023), *Edukimi seksual gjithëpërfshirës*, i disponueshëm në internet: <https://tinyurl.com/ynj9eve9>, qasja e fundit 28 gusht 2024.
- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) (2025), https://www.who.int/health-topics/female-genital-mutilation#tab=tab_1, qasja e fundit 3 mars 2025.

Ky dokument është hartuar me mbështetjen financiare të projektit "Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit", i zbatuar nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e paraqitura nuk reflektojnë opinionin zyrtar të Këshillit të Evropës.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE